

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7726 E shtunë 1 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga SKËNDER MINXHOZI



**P**as rreth një muaji protestash për projektin e Unazës së Re, banorët duket se po fillojnë të binden për të lejuar shembjen e mbi 300 ndërtimeve ku kanë jetuar prej...

Vijon në faqen 20

Fadromat e Unazës së Re dhe modeli i zhvillimit të Shqipërisë

Opinion

Ditës

NGA ANDI BUSHATI



**S**i gjithmonë, sa herë që Edi Rama Sshkel në Kosovë, apo flet për çështjen e saj, ai lë nga pas një gjurullid të vërtetë. Nuk bëri ndryshim as takimi i Pejës që...

Vijon në faqen 21

Rama s'lufton për kufij, por për like në "Facebook"



Dokumentet, PD: Prokuroria të hetojë

## "Përmbarimi sekuestron sërish kompaninë që fitoi tenderin e Unazës"

Kompania "Biba X" fitoi tenderin 18 milionë euro, Ina Zhupa: Është firmë fantazmë, faji i qeverisë

Nga VALENTINA MADANI

Partia Demokratike akuzoi dje se firma 'Biba X', e cila do ndërtojë një pjesë të Unazës së Re me një fond prej 18 milionë euro është vënë nën sekuestro nga përmbarimi. Sipas PD-së, kjo kompani ishte nën sekuestro edhe kur u tenderua ndërtimi i rrugës nga shkolla...

Në faqen 2

## PROJEKTIGJI/ 700 VETA DO TË DALIN NGA QELITE NE FUND TE 2018

# AMNISTIA NE BURGJE, TE DENUARIT QE PERFITOJNE

Gratë mbi 55 vjeç dhe burrat mbi 60 vjeç do të dalin nga burgjet. Përfitojnë edhe ata që kanë kryer vepra penale, që dënohen deri në 3 vite



(Në foto) Burgu i grave 313

Në faqen 5

LIGJI I RI

**Procedurat e reja për regjistrimin e pronave në zyrat e hipotekës**

Në faqen 4

PROJEKTI

**Protesta tek Unaza e Re, Rama: Ngërç artificial. Basha: Vjedhje**

Në faqen 3

BERAT

**Historia e dhimbshme, çifti i të moshuarve i jep fund jetës**

Në faqen 7

SUPERLIGA

**Tirana ka harruar të fitojë derbin, Partizani 4 pikë larg Skënderbeut**

Në faqen 22

FLET ISH-ZV.MINISTRI



**Taulant Muka: Arsimi ka buxhet 40 milionë euro, sa 2 kilometra rrugë tek Unaza e Re**

Në faqen 6



Zbulohet "misteri", Era Istrefi lidhet me ish-të dashurin e Pamela Anderson

## Pse u prish lidhja treshe e ish-misit Egla Harxhi

Stresi i surprizon të gjithë, telefonon "live" në TV me mesazh për Kejsin

Nga PAMELA ALIAJ

E dhe pse kanë kaluar vetëm 2 vite nga buja që bëri deklarata e ish-misit shqiptar, Egla Harxhi, lidhur me statusin e saj për një lidhje treshe, tashmë gjithçka ka ndryshuar. Para pak kohësh në zbuluan edhe se vajza, Alessia, që ishte



pjesë e kësaj tresheje kishte gjetur dashurinë diku tjetër. Po flasim pikërisht për lidhjen treshe që modelja kishte së bashku me partnerin francez, Jarl de Basserville dhe modelen nga Ballkani, Alessia. Por, pavarësisht bujës dhe zhurmës së madhe...

Suplement

# UNAZA E MADHE AKUZAT


Zhupa: Kompania 'Biba X', të paguajë detyrimet që i ka shtetit, jo të marrë 18 mln euro

## PD: Kompania nën sekuestro po shemb objektet tek Unaza e Re

"Afera gjigante, prokuroria të hetojë"

Valentina Madani

Partia Demokratike akuzoi dje se firma Biba X, e cila do ndërtojë një pjesë të Unazës së Re me një fond prej 18 milionë euro është vënë në sekuestro nga përbarimi. Sipas PD-së kjo kompani ishte nën sekuestro edhe kur u tenderua ndërtimi i rrugës nga shkolla teknologjike deri tek sheshi 'Shqiponja'. Partia Demokratike publikoi një dokument të datës 14 nëntor të lëshuar nga zyra e përbarimit, që sipas saj provon se kompania 'Biba X', pjesë e projektit të Unazës së Madhe, është nën sekuestro nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Sipas zëdhënësës së PD-së Ina Zhupa, përfshirja e kësaj kompanie në këtë projekt thellon paligjshmërinë e qeverisë në atë që ajo e cilëson aferë korruptive. Sipas Partisë Demokratike, duhet të paguajë detyrimet që i ka shtetit dhe jo të marrë 18 milionë euro prej tij. "Edi Rama ka thelluar edhe më shumë paligjshmërinë me Unazën e Re. Dokumenti që po publikojmë mban datën 14 nëntor dhe tregon se përbarimi ka vendosur në sekuestro me ekzekutim të detyrueshëm të gjitha asetet e kompanisë Biba X; konkretisht në kuotat ligjore të kompanisë, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, kantiere aktive të ndërtimit, llogari bankare etj. Në vend që të përfitojë 18 milionë euro nga buxheti i shtetit, kompania e paracaktuar nga Edi Rama për afërën korruptive të Unazës së Re, duhet të paguajë detyrimet që i ka shtetit", deklaroi zëdhënësja e PD Ina Zhupa. Ajo vuri në dukje se "Historia e sekuestros për kompaninë Biba X, që ka marrë tenderin korruptiv të Unazës së Re, bashkë me një kompani fantazëm, pa pronarë të identifikuar, është përsëritur". Zëdhënësja e PD-së tha se kompania që bashkë me Inspektoratin e Ndërtimit, shemb godina tek sheshi "Shqiponja", është nën sekuestro nga vetë IKMT-ja. Situata është



Faksimile e denoncimit të PD-së për kompaninë 'Biba X'

sa absurde, që edhe jo ligjore. Një kompani që ka çdo pasuri nën sekuestro dhe pasuritë e saj mund të dalin në ankand, nuk mund të kryejë punë publike. Në një situatë të tillë demokratët i

**DENONCIMI**  
PD denoncoi se firma Biba X, e cila do të ndërtojë një pjesë në Unazën e Re është vendosur sërish nën sekuestro nga përbarimi. Zëdhënësja Ina Zhupa përmendi se PD ka sjellë fakte se i gjithë projekti i Unazës së Re është i paligjshëm, korruptiv dhe në shkelje të plotë të vendimit të qeverisë



Gjatë protestës së banorëve të "Astirit"

**AKUZA**  
"Një kompani që ka çdo pasuri nën sekuestro dhe pasuritë e saj mund të dalin në ankand, nuk mund të kryejë punë publike. Në vend që të përfitojë 18 milionë euro nga buxheti i shtetit, kompania e paracaktuar nga Rama për afërën korruptive të Unazës së Re, duhet të paguajë detyrimet që i ka shtetit", tha z.Zhupa.

### Paguhet vetëm dietat dhe karburanti

## Bojkoti i Kuvendit, Ruçi u mban rrogat deputetëve të opozitës

Deputetëve të opozitës, bojkotit parlamentar u ka kushtuar rrogën mujore. Gjatë muajit tetor deputetëve të opozitës iu është hequr pagesa ditore për mospjesëmarrje në punimet e Kuvendit. Ata paguhen vetëm për dietat dhe karburantin e makinave ndërkohë që rroga mujore u është mbajtur për shkak të mungesës në parlament. Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi ka firmosur heqjen nga paga për pjesëmarrjen në komisione dhe në seanca, për të cilat sipas rregullores marrin 5 mijë lekë. Po ashtu në raportin e paraqitur për muajin korrik, deputetët që mbajnë rekord për mungesat janë Lefter Koka dhe Bujar Çela me 18 mungesa. Nga PD Edi Paloka kryeson me 17, i nd-



jekur nga Rudina Hajdari me 16 dhe Hekuran Hoxhalli me 15 të tilla. Sipas Statusit të Deputetit për marrëdhëniet financiare, neni 13 pika 2 sqaron se paga e deputetit përbëhet nga paga për pjesëmarrjen e tij në seancë, në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare. Mbështetur në po këtë nen si në korrik edhe në muajin shtator, tetor deputetëve të opozitës iu është hequr pagesa ditore

për mospjesëmarrje në punimet e Kuvendit. Vetëm gjatë pushimit në muajin gusht deputetët kanë marrë pagën e plotë. Prej datës 23 korrik PD dhe LSI kanë bojkotuar seancat parlamentare dhe komisionet në shenjë proteste për gjendjen e kimit si dhe për situatën e krijuar për ndërtimin e Teatrit të Ri Kombëtar. Një tjetër kërkesë është dhe miratimi i vetingut në politikë dhe reforma zgjedhore. Përpjesëtimet në buxhet mungesa e deputetëve ka mbajtur prej shumë javësh të bllokuar disa projektligje të rëndësishme, siç është ajo për shkollën e magjistraturës. Për bojkotin e opozitës në parlament ka folur edhe Parlamenti Europian, i cili i ka kërkuar opozitës që të kthehet në Kuvend.



Kreu i PD: Mbi banorët terror psikologjik, persona me profil kriminal, shtëpi më shtëpi

# 27 ditë protestë, Rama: Ngërç artificial. Basha: Anulo projektin

## "Në 40 mln euro investim, 30 janë vjedhje"

Valentina Madani

**B**anorët e zonës së "Astirit" bllokuan sërish të dy akset e rrugës gjatë protestës në zonën e Unazës së Madhe. Ndërsa banorët kishin bllokuar qarkullimin dhe thërrisnin "Qeveri hajdute", kreu i PD-së, Lulzim Basha, i rikthyer mbrëmë mes tyre akuzoi se në 40 milionë euro investim në projektin e zgjerimit të Unazës së Madhe, rreth 30 milionë janë vjedhje. "Këtu po vidhen me një dorë miliona euro, 20-30 milionë euro është fatura e vjedhjes, po të futet edhe përllogaritja e TVSH-së. Vjedhja e dytë që po bëhet është nxjerrja para festave të fundvitit në mes të katër rrugëve e mijëra familjeve vetëm që të mbushet thesi me para i agait të Surrelit", deklaroi kreu i PD-së. Basha garanoi se deputetët e opozitës nuk do t'i lënë vetëm qytetarët, duke denoncuar edhe kërcënimet e vazhdueshme që ata kanë marrë. I pyetur nëse PD do bëjë padi mbi këto akuzë, Basha tha: "Ka një padi nga banorët, heshtja e prokurorisë tregon se është një prokurori i kapur, e bërë palë me vjedhjen". Kreu i Partisë Demokratike tha gjithashtu se banorët po mbahen në presion vazhdimisht, por i garantoj se opozita do të jetë përkrah tyre në këtë kauzë të drejtë për ta. "Banorët ankojnë vazhdimisht se njerëz me profil kriminal brendhin derë më derë që t'u bëjnë presion apo për t'i joshur që të lënë banesat e tyre. Por deri më sot nuk ia kanë dalë. Do të jemi në krahun e tyre ditën dhe natën, nuk do t'i lëmë në këtë errësirë, ku i ka lënë Edi Rama, u ka hequr edhe ndriçimin. Kanë hequr edhe pemët hajdute mbrëmë. Do jemi bashkë me ta në një qëndresë të drejtë njerëzore, qytetare dhe kushtetuese. Mbi të gjitha, këta po mbrojnë shtëpitë e tyre", u shpreh kreu i opozitës. Po cila është zgjidhja që propozon kreu i opozitës? "Ka vetëm një zgjidhje, anulimi i këtij projekti korruptiv, hetimi i tij dhe çuarja para drejtësisë e atyre që kanë shkelur të gjitha ligjet e vendit dhe atyre që kanë ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike ndaj banorëve",



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dhe me banorët e Unazës së Re

**LULZIM BASHA**

"Ndaj banorëve po ushrohet terror psikologjik, ata marrin telefonata kërcënuese. Banorët thonë që persona me profil kriminal shkojnë shtëpi më shtëpi për të joshur apo frikësuar banorët që të tërhiqen nga protesta. Ka vetëm një zgjidhje, anulimi i këtij projekti, hetimi i tij dhe nxjerrja para drejtësisë e personave përgjegjës", tha Basha.

**EDI RAMA**

"Mirëmëngjesi! Dhe me këtë refleksim qytetar të Ukë Çelkolajt, i cili zgjodhi të kontribuojë për zgjidhjen e ngërçit të sajuar artificialisht tek Unaza e Re, duke dhënë një shembull kuptimplot për të gjithë bashkëqytetarët e atij komuniteti, ju uroj një ditë të qetë!", shprehet z.Rama.



### Bushati debaton me boshnjakët dhe serbët: Ne jemi në krah të Kosovës!

**P**unimet e ministerialit të ministrave të Jashtëm të Ballkanit Perëndimor nuk kanë qenë dhe aq të qeta. Ka qenë ministri i Jashtëm i Kosovës, Behgjet Pacolli, i cili ka kërkuar një ndryshim të vogël në deklaratën e përbashkët të ministrave të WB6. Ky propozim nuk është pritur aq mirë nga ministri i Jashtëm i Bosnje Hercegovinës, Igor Crnadak dhe përfaqësuesi serb në takim. Burime nga takimi bëjnë me dije se kërkesa e Pacollit për respekt të ndërsjellë për Kosovën në zbatimin e marrëveshjes CEFTA është mbështetur nga homologu shqiptar, Ditmir Bushati. Mësohet se ministri i Jashtëm shqiptar ka kërkuar një vendimarrje pozitive për kërkesën e Pacollit, duke bërë thirrje për kompromis. Debatu vijoi më tej teksa ministri i Jashtëm shqiptar theksoi se nëse Bosnja dhe Serbia nuk tregojnë mirëkuptim, atëherë edhe për Shqipëri dhe Kosovën është shumë e lehtë të kthehen tek qëndrimet kombëtare, por kjo nuk i shërben kompromisit. Burime brenda takimit bëjnë të ditur se ministri shqiptar ka qenë i mjaft i prerë. "Nëse për Serbinë e Bosnjën përbën problem futja e respektit të ndërsjellë në zbatimin e marrëveshjes së CEFTA-s, atëherë Shqipëria qëndron në krah të Kosovës dhe nuk pajtohet me asnjë deklaratë tjetër", mësohet të ketë thënë Bushati. Takimi i Budvës së WB6 i përfundoi punimet duke dalë me një tekst të përbashkët, tekst për të cilin nga pala shqiptare u insistua që të miratohet me konsensus pas kundërshtimit të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës për të pranuar ndryshimet e propozuara nga Kosova.

**MUSTAFAJ**

"Rama mendon se mund të shantazhojë Brukselin, por nuk mund të shantazhojë as Komisionin Evropian, as vendet anëtare të BE-së. Ka ikur koha e shantazheve. Janë lajthitje totale dhe janë krejtësisht jashtë klimës së BE-së, kur kanë mbetur edhe 5 muaj në hapjen ose jo të negociatave", tha Mustafaj në "News 24".

### Salianji: 80 të zhdukur nga droga në Vlorë? Do rihapim hetimin

**D**eputeti i PD-së, Ervin Salianji akuzoi dje qeverinë për lidhjen që Policia e Shtetit ka me krimin teksa iu referua situatën në Vlorë. Duke u bazuar në dëshmitë dhe shifrat që ka transmetuar emisioni "Top Story", deputeti demokrat deklaroi se frika dhe krimi po zënë gjithnjë e më shumë terren. Salianji deklaroi se denoncimi i dy muajve më parë i forcës së tij politike, se njerëzit rrëmbehen në Vlorë dhe zhduken pa lënë gjurmë, rezultuan çdo ditë e më shumë i vërtetë. Salianji u shpreh se policia nuk po bën asnjë përpjekje për të hetuar këto akte mafioze e konkretisht zhdukjen e personave të përfshirë në trafik droge. Duke u bazuar edhe te shifrat dhe dëshmitë që ka transmetuar emisioni "Top Story", Salianji tha



se pohimi i Prokurorisë së numri i të zhdukurve në 3 vjet është 80, është fals. Si pas deputetit demokrat, numri 80 përkon vetëm me numrin e denoncimeve që familjarët kanë bërë në polici për të afërmit e tyre. Ai citoi ndër disa dëshmi, edhe atë të babait të Mario Metushit, të zhdukurit në 16 qershor 2017, për të argumentuar pohimin se policia është bashkëpunuese e ngushtë e bandave të krimit. "Sa herë sh-

koja në polici për të denoncuar zhdukjen e djalit, më merrnin në celular dhe më thoshin, pse ke shkuar në polici?", - citoi Salianji babain e Metushit. Salianji u shpreh më tej se ajo çka i bashkon këto dëshmi është fakti se familjarët i bëjnë të gjitha denoncimet në policinë e Fierit, sepse sipas tij, deklarojnë se jo vetëm nuk kanë besim, por kanë frikë të shkojnë në policinë e Vlorës.

deklaroi z.Basha. Në mbështetje të protestës së banorëve të "Astirit", përveç kreut të PD-së, Lulzim Basha ishin edhe shumë deputetë të opozitës. Bëhet fjalë për deputetët Ervin Salianji, Kejdij Mehmetaj, Valentina Duka, Luçiano Boçi, Nora Malaj, Aldo Bumçi etj. Më herët, kryeministri Edi Rama zgjodhi ta nisë ditën e djeshme me një video, ku pasqyrohet shem-

bja e banesave të paligjshme të njeriut banor të Unazës së Re, në kuadër të projektit të zgjerimit të saj. Përmes rrjetit social "Facebook", Rama e cilësoi vazhden e protestave të banorëve të zonës si një ngërç të sajuar artificialisht. Duke e lidhur me deklaratat e bëra së fundmi të Ukë Çelkolajt, i cili pranoi pa kundërshtuar prishjen e dy objekteve të tij, kreu i ekzekutivit shkruan

më tej se ky i fundit është një shembull kuptimplot për bashkëqytetarët e komunitetit në fjalë. "Mirëmëngjesi! Dhe me këtë refleksim qytetar të Ukë Çelkolajt, i cili zgjodhi të kontribuojë për zgjidhjen e ngërçit të sajuar artificialisht tek Unaza e Re, duke dhënë një shembull kuptimplot për të gjithë bashkëqytetarët e atij komuniteti, ju uroj një ditë të qetë!", shprehet z.Rama.

# KADASTRA REFORMA

Kadastra do të krijojë një regjistër kadastral të ri për të gjitha pronat

## Ligji, procedurat e reja për regjistrimin e pronave në hipotekë

Trajtimi i kërkesave bëhet brenda 15 ditëve

Qeveria socialiste kërkon që të vendosë një regjim krejt të ri sa i përket çështjes së pronave në vend. Krahas nismës së saj për të bashkuar tri institucione dhe funksionet e tyre në atë që do të quhet Kadastra, ekzekutivi në projektligjin e paraqitur për miratim në Kuvend ka parashikuar edhe një sërë ndryshimesh të rëndësishme me atë që të cilave kërkon t'i jap zgjidhje gjithë problematikës së mbartur me pasuritë e paluajtshme në Shqipëri. Një prej rrisive që sjell ky draft ka të bëjë edhe me regjistrimin e titujve të pronësisë në kadastrë. Kështu, kjo nismë ligjore përcakton se për çdo zonë kadastrale drejtoria vendore mban një regjistër kadastral zyrtar, ku shënon të dhëna të ekstraktuara nga dosjet e pronësisë të të gjithë pronarëve të zonës kadastrale. Ajo regjistron titujt që ajo krijon nga veprimtaria në zbatim të legjislationit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë" dhe titujt që krijojnë nga marrëdhëniet juridiko-civile ndërmjet subjekteve të së drejtës private nga vendimet gjyqësore apo nga akte të organeve të tjera shtetërore. Me aktin e regjistrimit dhe lëshimin e certifikatës, drejtoria vendore garanton formalisht titullin e pronësisë në favor të pronarit ose bashkëpronarëve. Më lëshimin e certifikatës pronarit i lind e drejta për ta disponuar pronën lirish, për aq sa ajo nuk ka barrë hipotekore. Përveç rasteve të korigjimit të pasaktësive hartografike dhe gabimeve materiale apo përmirësimepërditësimit të regjistrit, drejtoria vendore nuk mund të ndryshojë titullin e pronësisë pa një dokument notarial, që konfirmon vullnetin e pronarit për këtë ndryshim ose një vendim gjyqësor. Ndërkohë që çdo akt që sjell ndryshime dhe/ose përfitim të drejtave të pronësisë, duhet të regjistrohet me patjetër brenda një harku kohor prej 30 ditësh. Në të kundërt, poseduesi i atij akti do të përballet me gjoba që shkojnë deri në 3 milionë lekë.



ZRPP Tiranë

**AFATI**  
Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale nëpërmjet një akti ku këto të drejta përbahen, duhet të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e aktit brenda 30 ditëve nga koha e realizimit të tij në drejtorinë vendore të kadastrës.




Foto ilustruese

**GJOBA**

Nëse kërkesa për regjistrim paraqitet tej afatit 30-ditor, përveç tarifës së regjistrimit, kërkuesi duhet të paguajë edhe kamatëvonesë për çdo ditë tej afatit, e barabartë me 10% e tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë.

**PROJEKTLIGJI**

**NENI 22**

**Regjistrimi i titujve të pronësisë**

1. Për çdo zonë kadastrale, drejtoria vendore mban një regjistër kadastral zyrtar, ku shënon të dhëna të ekstraktuara nga dosjet e pronësisë të të gjithë pronarëve të zonës kadastrale.
2. Regjistri përban detyrimisht këto të dhëna:
  - a) Gjenealogjetit e pronarëve sipas dokumentit të identifikimit, si dhe numrin e datën e aktit me të cilin është krijuar marrëdhënia e pronësisë.
  - b) Numrin e certifikatës së pronësisë të lëshuar pas regjistrimit.
  - c) Statusin ligjor të pasurisë në raport me detyrimet që pronari ka me të tretët.
  - d) Ndryshimet në statusin e pronësisë në vite, të shoqëruara me ekstraktet e dokumenteve të reja.
  - e) Të dhënat e tjera që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Regjistri kombëtar i titujve të pronësisë krijohet dhe administrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

**NENI 23**

**Pasojat juridike të regjistrimit**

1. Drejtoria vendore kadastrale regjistron:
  - a) titujt që ajo krijon nga veprimtaria në zbatim të legjislationit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë".
  - b) titujt që krijojnë nga marrëdhëniet juridiko-civile ndërmjet subjekteve të së drejtës private nga vendimet gjyqësore apo nga akte të organeve të tjera shtetërore.
2. Drejtoria vendore me aktin e regjistrimit dhe lëshimin e certifikatës garanton formalisht titullin e pronësisë në favor të pronarit ose bashkëpronarëve. Më lëshimin e certifikatës pronarit i lind e drejta për ta disponuar pronën lirish, për aq sa ajo nuk ka barrë hipotekore.
3. Përveç rasteve të korigjimit të pasaktësive hartografike dhe gabimeve materiale apo përmirësimepërditësimit të regjistrit, drejtoria vendore nuk mund të ndryshojë titullin e pronësisë pa një dokument notarial që konfirmon vullnetin e pronarit për këtë ndryshim ose një vendim gjyqësor.

**NENI 24**

**Regjistrimi i detyruar**

1. Çdo akt, që sjell ndryshime dhe ose përfitim të drejtave të pronësisë, duhet të regjistrohet.
2. Gjykatat, noterët, përbaruesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore që veprojnë në fushën e

pasurive të paluajtshme janë të detyruar që çdo akt të tyre që përban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie ose të një të drejte tjetër reale ose që deklarohen të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, ta deklarojnë në kadastrën digjitale kombëtare (bazës kombëtare të të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme), që në momentin e formalizimit të aktit. Për zbatimin e kësaj dispozite, ASHK-ja u siguron organeve të sipërpërmendura akses në kadastrën digjitale.

**NENI 25**

1. Çdo person, mbajtës i titullit të pronësisë apo i një të drejte reale nëpërmjet një akti ku këto të drejta përbahen, duhet të paraqesë një kërkesë për regjistrimin e aktit brenda 30 ditëve nga koha e realizimit të tij.
2. Nëse kërkesa për regjistrim paraqitet tej afatit 30 ditor, përveç tarifës së regjistrimit, kërkuesi duhet të paguajë edhe kamatëvonesë, për çdo ditë tej afatit, e barabartë me 10% e tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300 000 lekë.

**NENI 26**

**Pamundësia për regjistrim**

1. Drejtoria vendore, kur konstaton se akti notarial, vendimi i gjykatës apo akti administrativ që përcakton kalimin e pronësisë ose ndryshimin e statutit të saj është i paqartë, pezullon procedurën dhe njofton kërkuenin. Në këtë rast kërkuesi i kërkohet të paraqesë qartë informacionin e nevojshëm, brenda një afati 30-ditor.
2. Do të konsiderohet informacioni i paqartë, për efekt regjistrimi: a) mungesa e identitetit ose mospërfutheja me identitetin në kartelën e pasurisë; b) mospërcaktimi i pronës në kufij, sipërfaqe dhe në pozicion gjeografik të saktë.
3. Në rast se pronari nuk arrin të saktësojë këtë informacion, zyra kadastrale refuzon regjistrimin.

**NENI 27**

**Vendosja e kufizimeve të përkohshme**

1. Përveç sa parashikohet në dispozita të veçanta në këtë ligj, drejtuesi i drejtorisë vendore kadastrale ose drejtori i Përgjithshme mund të urdhërojë ndalimin e veprimeve në çdo kartelë, hartë apo zonë kadastrale, vetëm në këto raste:
  - a) Për të parandaluar një mashtrim ose veprim të padrejtë që ka për qëllim kalimin e pronësisë në

mënyrë të paligjshme;  
b) Kur e kërkojnë strukturat e kontrollit ose të trajtimit të ankimave të Drejtorisë së Përgjithshme, për arsye të evidentimit të veprimeve të paligjshme mbi pasuritë.  
3. Urdhri lëshohet me shkrim edhe pa kërkesën e personit të interesuar dhe i njoftohet nëpunësit që administrojnë praktikën përkatëse.  
4. Drejtoria vendore kadastrale është e detyruar të njoftojë pronarin për lëshimin e urdhrit të ndalimit të veprimeve. Kundër urdhrit të ndalimit pronari mund të bëjë ankesë në gjykatë.

**Neni 28**

Garantimi i aksesit mbi ekstrakt dhënave personale, sipas legjislationit në fuqi, nëpërmjet disa niveleve të sigurisë, të përcaktuara nga udhëzimet e Drejtorisë së Përgjithshme.  
2. Personave juridikë/fizikë, vendas apo të huaj, u jepet kodi i hyrjes dhe e drejta e marrjes së ekstrakteve të të dhënave, në mënyrë të drejtpërdrejtë, vetëm nga kadastra digjitale, duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të saj nëpërmjet sistemit elektronik.

**NENI 29**

**Kërkesa dhe afatet**

1. Çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkesë. Kërkesa është një formular tip që gjendet në sportelet e shërbimit ose 'online'. Modeli i kërkesës miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme sipas llojit të shërbimit që kërkohet.
2. Agjencia publikon të gjitha llojet e shërbimeve që kryen kadastra, formularin e kërkesës përkatëse dhe dokumentacionin shoqëruar të kërkuar për çdo shërbim. Publikimi duhet të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për çdo shtetas.
3. Çdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit.
4. Në rast pamundësie, drejtoria vendore njofton menjëherë kërkuenin për arsye e pamundësisë dhe vendos afatin e ri, por jo më shumë se gjysma e afatit të vendosur për çdo shërbim.
5. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave.



**PROJEKTLIGJI**

Projektligji parashikon se nuk mund të përfitojnë nga amnistia të dënuarit për krime kundër njerëzimit, krime seksuale, vepra penale kundër moralit dhe dinjtetit, vrasje me paramendim apo me dashje, si dhe ata që kanë kryer vepra penale kundër fëmijëve, martesës ose familjes, si dhe për korrupsion të zyrtarëve

**VEPRAT QË PËRJASHTOHEJN NGA AMNISTIA**

- Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:
  - a) Krime kundër njerëzimit, të parashikuar në nenet 73, 74, 74/a e 75 të Kodit Penal
  - b) Krimet kundër jetës me dashje të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/c, 81, 82, 83/a, 83/b e 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak.
  - c) Për vepra penale të kryer me dashje kundër shëndetit të parashikuar në nenet 86, 97, 88, 89/a, e 99 të Kodit Penal;
  - ç) krime seksuale të parashikuara në nenet 100, 101, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;
  - d) vepra penale kundër lirisë së personit të parashikuara në nenin 114 dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 109/b dhe 109/c; në paragrafin e dytë të nenit 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;
  - dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjtetit, të parashikuar në nenin 114 dhe në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 117 të Kodit Penal.
  - e) Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 124, paragrafin e dytë e të tretë të nenit 124/b; në nenet 128/a, 128/b e 130/a të Kodit Penal
  - ë) Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve të parashikuara nga nenet 325 deri në 331.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Zyra përbarimtare "Besti 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 28 dhjetor 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përbarimtare do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e III-të, për shpëtimin e pasurisë "MUSHIQI" shpk të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës. Prona përbëhet nga dy dyqane (gjithsej rreth 245 m2) dhe tre apartamente (gjithsej rreth 245 m2) dhe mbi këto prona nuk rëndon barrë hipotekore apo nuk janë të kullizuara nga detyrime të tjera.

Çmimi fillestar për çdo apartament do të jetë 34.000 lek/m2, ndërsa çmimi fillestar për dyqan do të jetë 51.000 lek/m2. Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: 052226000 ose cel: 0692075 644

Projektligji parashikon të amnistojë gratë mbi 55 vjeç dhe burrat mbi në 60 vjeç

# Falen 700 të burgosur, ja kategoritë që përfitojnë

*Lënë qelitë edhe ata që janë dënuar deri në 3 vjet*

Rreth 700 të burgosur që vuajnë dënime të ndryshme në të gjitha burgjet e Shqipërisë do kenë mundësi që vitin e ri ta kalojnë pranë familjeve të tyre. Qeveria ka vendosur që për shkak edhe të mbipopullimit të burgjeve, por edhe në kuadër të politikave humane në prag të festave të ushtrisë të drejtën e amnistisë për të gjithë ata persona që nuk kanë kryer vepra të rënda penale ose për persona në moshë të madhe ose për ata që në momentin e kryerjes së veprës kanë qenë më të vegjël se 18 vjeç. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë ka hartuar projektligjin përkatës, të cilin ia ka çuar për mendim Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë, përpara se të procedojë më tej me miratimin në qeveri dhe më pas në parlament.



**KUSH PËRJASHTOHEJ**

Por pavarësisht faktit nëse i plotëson ose jo kriteret e mësipërme projektligji bënë dhe një sërë ndalesash, duke përjashtuar një kategori të madhe veprash, të cilat nuk mund të amnistohen.

Kështu projektligji parashikon se nuk mund të përfitojnë nga amnistia të dënuarit për krime kundër njerëzimit, krime seksuale, vepra penale kundër moralit dhe dinjtetit, vrasje me paramendim apo me dashje, si dhe ata që kanë kryer vepra pe-

nale kundër fëmijëve, martesës ose familjes, si dhe për korrupsion të zyrtarëve. Po ashtu nuk do të kenë mundësi të përfitojnë as personat e dënuar me vendim të formës së prerë për krime që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve.

## Do lënë burgjet edhe të miturit, rastet e përjashtimit

Nga amnistia do të përfitojnë edhe të gjithë ata të dënuar që kanë kryer një krim në moshë të mitur. Projektligji i hartuar nga Ministria e Drejtësisë parashikon që t'i falë vitet e mbetura të burgimit për të gjithë ata të dënuar që kanë kryer një vepër të caktuar penale në moshën nën 18 vjeç. Më konkretisht drafti i parashikuar për mendim parashikon të amnistohen edhe personat e dënuar me burgim, të cilët, në kohën e kryerjes së veprës penale, kanë qenë bars ose nën moshën 18 vjeç, pavarësisht nga ndalimet e nenit 4. Por ashtu si edhe në rastin e të rriturve edhe për këtë kategori ligji bënë një sërë përjashtimesh nga amnistia. Pra nuk do të përfitojnë nga amnistia, pavarësisht faktit se i dënuari mund ta ketë kryer veprën në moshë të mitur, të gjithë ata që kanë bërë krime të rënda, si vrasje me dashje, marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitur, pjesëmarrje në grupe kriminale etj.

**VEPRAT PENALE PËR TË CILAT PËRJASHTOHEJ AMNISTIA PËR TË MITUR**

- Vrasja me dashje
- Vrasja me dashje në lidhje me një krim tjetër
- Vrasja me paramendim
- Vrasja për gjakmarje
- Vrasja në rrethana të tjera cilësuese
- Vrasja e funksionarëve publikë
- Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit
- Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare
- Vrasja e foshnjës
- Tortura me pasoja të rënda
- Plagosja e rëndë me dashje, kur është kryer kundër disa personave, kundër personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afër ose krushqje e afër me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen.
- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur
- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç
- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur
- Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës
- Dhuna seksuale
- Vepra të turpshme
- Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit
- Trafikimi i personave të rritur
- Vjedhja me dhunë
- Vjedhja me armë
- Vjedhja me pasojë vdekjen
- Organizata terroriste
- Banda e armatosur
- Trafikimi i armëve dhe i municionit
- Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive
- Trafikimi i narkotikëve
- Organizata kriminale
- Grupi i strukturuar kriminal
- Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal

## ARSIMI NË SHQIPËRI

### INTERVISTA

Flet ish-zv.ministri i MASR: Meritokracia ngatërrohet me servilizimin e partinë politike

# Taulant Muka: Diplomat e universiteteve publike nuk njihen nga shteti shqiptar

## "Ministria e Arsimit, mjet për të thithur elektoratin"

Shteti shqiptar nuk i njeh diplomat që marrin studentët nga universitetet publike në vend, pasi programet e studimit janë të paakredituara. Denoncimi vjen nga ish-zv.ministri i Arsimit, Taulant Muka, i cili në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" tregon se pavarësisht tarifave të larta, niveli i mësimdhënies dhe infrastrukturës në universitetet është i dobët. Muka më tej shton se qeveritë shqiptare historikisht nuk kanë investuar në arsim e madje politika e shikon rininë si militant, dhe jo si potencialin më të madh të vendit. Muka shton se pozicioni i zv/ministrit i ishte dhënë jo për të bërë punë, por për të mbyllur gojën. Sipas tij MASR, nuk ka asnjë funksion ekzekutiv e drejtuesit aktual të ministrisë e shohin arsimin jo si mjetin përmes së cilës ti ndërton të ardhmen e një vendi, por si një mundësi për të thithur elektorat.

**Prej disa kohësh ju keni ngritur zërin lidhur me problematikat në arsim. Mund të përmendni më specifikisht se cilat janë ngërçet në arsimin shqiptar?**

Qeveritë shqiptare historikisht nuk kanë investuar në arsim, besoj në mënyrë të qëllimë. Do të mundohem një vend, hiqi dijen! Kjo ka ndodhur dhe po ndodh në vendin tonë. P.sh. buxheti i qeverisë shqiptare që ju shpërndahet universiteteve publike është 40 milionë euro, një shumë e barabartë me 2 kilometra rrugë te Astiri. Pra, përgatitjen e profesionistëve të shëndetit, ekonomisë, inxhinierisë, teknologjisë, shërbyesve socialë etj. qeveria jonë e vlerëson me dy kilometra rrugë. Për këtë arsye, por jo vetëm, universitetet shqiptare kanë shume probleme: në auditore ka lektorë që nuk kanë lidhje me edukimin, madje janë të lidhur me krimin (ju kujtoj rastin e z.Shoraj). Struktura rinore e partisë më të madhe në vend sot numëron mbi 40.000 anëtarë, pothuajse 30% të studentëve aktual të regjistruar në arsimin e lartë! Pra, sot politika e shikon rininë si militant, dhe jo potencialin më të madh të vendit ku ne si vend duhet të investojmë!

**Shpeshherë ju keni hedhur akuza mbi persona në poste drejtuese të cilët kanë diploma false. Ku bazoheni dhe a mund të përmendni disa emra?**

Shikoni CV-të që paraqesin: një pjesë e mirë

#### PROBLEMATIKAT E MASR

Në Ministrinë e Arsimit mungon praktika e punës. Në këtë institucion flitet shumë, por shumë pak dokumentohet. Për më tepër kuptova që pozicioni i zv/ministrit më ishte dhënë jo për të bërë punë, por për të mbyllur gojën. Nuk ka asnjë funksion ekzekutiv.



Ish-zëvendësministri i Arsimit, Taulant Muka

#### RYSHFETET NE UNIVERSITETE

Një studim i kryer nga Qëndresa Qytetare tregoi se mbi 70% e studentëve pohojnë se në universitetet ka korrupsion. Blihet nota, shiten libra me detyrim, kërkohen favore seksuale për të marrë një notë më të mirë, studenti paguan për një vërtetim të thjeshtë; këto janë disa shqetësime konkrete dhe shumë shqetësuese që denigrojnë figurën e universitetit.

#### PROBLEMATIKAT NE ARSIM

Qeveritë shqiptare historikisht nuk kanë investuar në arsim, besoj në mënyrë të qëllimë. Do të mundohem një vend, hiqi dijen! Kjo ka ndodhur dhe po ndodh në vendin tonë. P.sh. buxheti i qeverisë shqiptare që u shpërndahet universiteteve publike është 40 milionë euro, një shumë e barabartë me 2 kilometra rrugë tek "Astiri".

nuk përmendin ku kanë mbaruar universitetin, një pjesë deklarojnë shtetin dhe jo universitetin ku supozohet janë diplomuar, disa përmendin vitin kur kanë filluar punë në një organizatë/biznes, por jo vitin e diplomimit. Janë indikator domethënës që ngrenë dyshime për vërtetësinë e diplomave. Ka patur akuza më parë për disa politikanë, si për kryetarin e bashkisë së Tiranës, apo kryetarin e opozitës që nuk kanë diploma. Nëse dikush i ka diplomat, nuk ka frikë t'i nxjerrë kur ka akuza të tilla, dhe për më tepër nëse ka studiuar jashtë. Unë në mënyrë informale kam informacione që vërtetojnë disa nga këto shqetësime. Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe zyrës së kryeministrit për shembull i kam paraqitur

**Gjatë dy javëve si zv. ministër i Arsimit, cilat ishin disa nga problematikat që arritët të konstatoit brenda kësaj ministrie çka iu bëri dhe të dorëhëqesht?**

Në ministrinë e arsimit mungon praktika e punës. Në këtë institucion flitet shumë, por shumë pak dokumentohet. Për më tepër kuptova që pozicioni i zv/ministrit më ishte dhënë jo për të bërë punë, por për të mbyllur gojën. Nuk ka asnjë funksion ekzekutiv. Gjithashtu, drejtuesit aktualë të ministrisë e shohin arsimin jo si mjetin përmes së cilës ti ndërton të ardhmen e një vendi,

por si një mundësi për të thithur elektorat. Kur propozova 12 emra studiuesish me produkt shkencor për anëtarë të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, në Ministrinë e Arsimit më thanë: "Këta si një publiku, nuk sjellin votat!" Arsimi në Shqipëri është i marrë peng nga politika! Etika, morali dhe përgatitja ime profesionale nuk më lejon të punoja në një institucion të tillë, mund të kontribuoj më shumë për vendin tim dhe zhvillimin e arsimit në vend jashtë sistemit.

**Sa i pranishëm është korrupsioni në universitetet shqiptare? Si mund t'i jepet zgjidhje kësaj situatë?**

Një studim i kryer nga Qëndresa Qytetare tregoi se mbi 70% e studentëve pohojnë se në universitetet ka korrupsion. Blihet nota, shiten libra me detyrim, kërkohen favore seksuale për të marrë një notë më të mirë, studentit paguan për disa vërtetim të thjeshtë; këto janë disa shqetësime konkrete dhe shume shqetësuese që denigrojnë figurën e universitetit. Është e turpshme ne të flasim për këto probleme në vitin 2018, jemi shekuj mbrapa krahasuar me vendet ku ne duam të aderojmë.

**A janë të akredituara programet e studimit në IAL-të publike në vend?**

Sot, studentët në universitetet publike marrin diploma që shteti shqiptar, sipas ligjit të 2015, nuk i njeh, sepse janë programe të pa akredituara! Studentët shqiptarë paguajnë tarifa të larta, gjejnë në universitetet infrastrukturë të dobët dhe nivel të ulët mësimdhënies, dhe në fund marrin diploma që jo vetëm nuk kanë vlerë, por dhe nuk njihen nga shteti shqiptar! Pse ministria dhe qeveria kanë lejuar kjo të ndodhë, ndërkohë që universitetet private i kanë akredituar programet e tyre? Ky ndoshta është korrupsioni më i madh sot: denatet e universiteteve, dekanët dhe rektorët, dhe vetë ministria, që paguhen nga taksat tona, janë në shkelje të ligjit, dhe sot të gjithë duhet të mbajnë nëpërkëmbetësi.

**Sa dëgjohe zëri i intelektualëve në Shqipëri?**

Intelektuali shqiptar është përndjekur për disa dekada nga qdo pushtet dhe vazhdon të nëpërkëmbet në vendin tonë dhe emigrojnë drejt vendeve të tjera! Raporti i publikuar së fundmi nga UNESCO tregon se më shumë se 1 në 4 Shqiptarë me aftësi të lartë (highly skilled-një person i cili është i aftë të punojë në mënyrë efikase dhe të tra-

jnojë me efektshmëri punëtorë të aftë) emigrojnë! Rritimi i emigrimit të njerëzve të edukuar në Shqipëri është i përafërt me vendet si Somalia!

**Cfarë do të sjellë gjithë kjo situatë për vendin tonë, cilat do të jenë pasojat sipas jush?**

Ish presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barack Obama thotë: Nëse mendoni se arsimi kushton, prisni të shikoni sesa injoranca kushton. Shkatërrimi i arsimit ka sjellë që vendi jonë të mos ketë specialistë në shumë fusha, arsim, ekonomi, ndërtim, mjedis, bujqësi etj. Kjo ka sjellë plagë të shumta sociale në vend, dhe dëm të madh ekonomik.

**Pse studentët shqiptarë dhe të sapodiplomuarit zgjedhin të largohen nga Shqipëria?**

Sot shqiptarët nuk dinë çfarë duan, sepse nuk ka profesionistë që përmes hartimit të politikave të bazuara në evidencë orientojnë tregun dhe zhvillimin social, ekonomik dhe urban. Rinia largohet sepse sistemi shqiptar vret të aftin, nuk e ndihmon të zhvillojë potencialin e veta dhe ecë përpara. Meritokracia në vendin tonë ngatërrohet me servilizimin dhe partinë politike.

NDIHMJA E HUAJ



Ambasadori i Bashkimit Europian në Shqipëri, Luigi Soreca bën me dije se një zyrtar i Europol do të jetë tashmë në Policinë e Shtetit nga janari i 2019. Soreca tha se lufta kundër krimit është prioritet për BE dhe se bashkëpunimi do të jetë më i rëndësishëm se kurrë kundër grupeve kriminale të stilit mafioz, duke përfshirë krimin e organizuar shqiptar.

Lufta kundër krimit, zyrtari i Europol pjesë e policisë

Ambasadori nënvizoi se "lufta kundër krimit të organizuar është një prioritet për Bashkimin Europian. Policinë e Europolit, BE-së dhe Italisë, së bashku me ato të Gjermanisë, Francës, Belgjikës, Spanjës

dhe Holandës kanë themeluar një rrjet operacional për forcimin e bashkëpunimit mes tyre në luftën kundër grupeve kriminale të stilit mafioz, përfshi edhe krimin e organizuar shqiptar. Bashkëpunimi ndërkombëtar do të jetë më i

rëndësishëm se kurrë. Për këtë qëllim, transferimi i një oficeri ndërlidhës të Europolit pranë Policisë së Shtetit, duke nisur nga janari i 2019, është një hap i rëndësishëm. Kjo do të ndihmojë në fuqizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit aktual mes policisë shqiptare dhe policive të vendeve anëtare të BE-së", shkruan Soreca.

Denoncuesja flet për dramën e jetës së saj deri në divorcin nga bashkëshorti

# Nëna e fëmijës autik: Mua më rrihte, djalin e plaste nga muri "Burrin e arrestuan, bëri 2 vite burg"

**E**misioni "BOOM" transmetoi mbrëmë dramën e një nëne të re nga Fieri, prej 5 vitesh e divorcuar. Ajo është vetëm 32 vjeç. U detyrua që të braktisë Fierin për të jetuar së bashku me djalin 6-vjeçar në Tiranë. Arsyeja është se ish-bashkëshorti ishte i dhunshëm në familje jo vetëm ndaj saj, por edhe ndaj djalit të tyre, i cili vuan nga autizmi.

**Denoncuesja:** Kam një 1 vit e 2 muaj në Tiranë. Kam 5 vjet e divorcuar, jam divorcuar për dhunë në familje. Gjatë gjithë kohës më duhet të isha burri i shtëpisë, punoja në dy punë. Laja komplet detyrimet e shtëpisë, isha e detyruar të usheqja dhe burrin, t'i blija cigare dhe sa orë kishte dita ai shkonte në lojërat e fatit. Lekët që unë punoja për t'i blerë bukë fëmijës ai m'i merrte, nëse nuk ia jepja sa orë kishte dita unë haja dru dhe djali hidhej nëpër mure. E kishte çarë nga kurrizi me thonj, e kishte djegur me cigare. Kam njoftuar policinë. Kur erdhi ekspertiza që mori djalin, e ka parë gjendjen mendore të djalit shumë të rëndë, e kanë zhveshur, i kanë parë shenjat e trupit. Ata e arrestuan direkt, ka bërë dy vjet burg.

Pasi policia konstaton shenja dhune te trupi i fëmijës e arreston bashkëshortin e 32-vjeçarës, i cili dënohet me 2 vite burg. E vetme dhe pa përkrahje, 32-vjeçarja me fëmijën në krah vjen në Tiranë dhe merr një shtëpi me qira.

Gjithë pagesa që merr nga KEMP-i fëmijës shkon për pagesën e qirasë, ndërsa mes lotësh ajo thotë se nuk i mbush dot barkun me bukë djalit të vogël.

Edhe pse ka mbaruar shkollën si infermiere, e ka të pamundur për të punuar për arsye se fëmija do kujdes në çdo moment.

**Denoncuesja:** Djalit u lidh një KEMP prej 100 mijë lekësh të vjetra për diagnozën e autizmit. Më



parë me ato paguaja qiranë, korrentin shpesh e lija pa paguar, vinin këta të elektrikut dhe ma prisnin. Ujë nuk kishte. Merrja ushqime borxh, trokisja në një kishë për të marrë ndonjë çantë me makarona.

Jam infermiere me profesion, e kam ushtruar prej katër vitesh. Kam diplomë të nivelit të parë për infermiere. Dua shumë të punësohem, por askush nuk më mbështet. Kërkoj të më mbështesin. Nuk është e thënë që unë të futej patjetër infermiere. Për shkak të kushteve, jam e vetme, dua ta trajtoj këtë fëmijë në një ambient spitalor, edhe në reception të më fusin, ose ndihmësinfermiere. Ju bëj thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi të më ndihmojnë

me çfarë të munden. Nuk kam lavaman të laj enët, jam e detyruar t'i laj në mes të shtëpisë. Ai nuk duhet të zbrësë poshtë se lag këmbët. Ose lan lavatrica j rrobat, e derdh ujën se nuk ka kanalizim, e derdh në mes të shtëpisë. Djali është i detyruar që gjatë gjithë kohës të rrijë në

majë të krevatit dhe bëhet shumë agresiv. 32-vjeçarja tregon se e regjistroi fëmijën në shkollën "Luigj Gurakuqi" në Tiranë, por për 2 muaj gjendja e djalit u përkeqësua.

Ai vinte në shtëpi i çjerrë nga fytyra dhe u mbush me parazitë.

**ARRESTIMI**

Pasi policia konstaton shenja dhune te trupi i fëmijës e arreston bashkëshortin e 32-vjeçarës, i cili dënohet me 2 vite burg. E vetme dhe pa përkrahje, 32-vjeçarja me fëmijën në krah vjen në Tiranë dhe merr një shtëpi me qira.

jve asnjë terapi nuk iu bë dhe logopedistja asnjë herë nuk e mori.

Përpos kësaj fëmija dy muaj rresht më ka ardhur nga fytyra i grirë sallat, më vinte i rrahur se nga fëmijët, se nga... Nuk e di, se aty janë dhe fëmijët e sëmurë. Telefonova mësuesen e djalit dhe më tha po fëmijë janë, të sëmurë janë.

Ik se kam punë dhe më ka mbyllur telefonin. Ndërsa psikologja e shkollës më tha se më vjen keq për fëmijën tënd, kushtet janë shumë të këqija, them që ta heqësh që këtu. Ajo e ka pohuar dhe në bashki. Fëmija, gjithashtu, krueh nga flokët, kur i hap flokët i mbushur plot me parazitë.

E çova te berberi dhe e qetha tullë. Tani e kam në një kopsht privat. Të gjithë KEMP-in që marr e jap aty që djali të paktën të jetë mirë, t'i dhurojnë dashuri dhe të ngopë barkun, të mos rrijë me bark bosh.

Ata u kërkoi fëmijëve të tyre shpesh që t'i kthenin në fshat

## Ngjarje tragjike në Berat, çifti i të moshuarve vdes duke u hedhur nga kati 8

**N**jë ngjarje tragjike u regjistrua në Berat, ku një çift të moshuarish u gjetën të pajetë poshtë pallatit ku banonin. Burrë e grua me probleme shëndetësore, ishin transferuar në qytet disa muaj më parë, por nuk ishin ambientuar dhe sipas familjarëve shpesh herë u kërkoi fëmijëve t'i kthenin në fshatin ku jetonin më parë.

**BERAT-** Kujtim dhe Këze Agalliu, të moshuarit që i dhanë fund jetës në mënyrë tragjike në Berat e kishin paralajmëruar aktin ekstrem.

Të vendosur në qytet vetëm 6 muaj më parë, ku jetonin të vetëm çifti 78 dhe

70 vjeçe nuk kishin arritur të ambientoheshin dhe u kishin kërkuar katër fëmijëve që jetonin në emigrim t'i kthenin në Qereshnik.

Në të kundërt i kishin kërcënuar se do t'i jepnin fund jetës, ashtu siç edhe ndodhi mëngjesin e kësaj të premtjeje, konfirmuan të afërm të familjes.

Më datë 30.11.2018, rreth orës 07:00, në vendin e quajtur "Pjeshkorja", në lagjen "30

Vjetori", Berat, shërbimet e patrullës konstatuan një çift të moshuarish, të cilët dyshohet se janë hedhur nga kati i 8-të i pallatit, duke gjetur vdekjen", raportoi policia e Beratit.

**HETIMET**

Sipas hetimeve të para dyshohet se ka qenë burri ai që ka hedhur nga ballkoni i katit të tetë ku jetonin gruan dhe më pas është hedhur vetë. Që të dy kishin edhe prob-

leme të rënda shëndetësore çka ka përkeqësuar gjendjen e tyre psikologjike.

Burri vuante nga probleme të shëndetit mendor dhe skizofrenia, ndërsa grua ishte konstatuar me tumor, siç konfirmojnë edhe të afërmit.

Të dhënat e para të policisë flasin për një akt ekstrem në kushtet e depresionit, por megjithatë pritet marrja në pyetje e familjarëve të çiftit dhe dëshmitarëve.

**Shitje me Ankand të trete nga Studio Permbarrimore L.D.C**

1. "Ndertesë" me sferifage 600 m2, me Nr. Pasurie 495/15, Volum 5, lqage 83, ndodhur në Zonen kadastrale 3426 me adresë në Tullinë, Tiranë. Regjistruar në Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Pajualjishme Tiranë. Çmimi fillestar për shitje është 2.116.800 leke.

Data e shpalljes 30.10.2018  
Data e zhvillimit 03.11.2018 deri në orën 16:00

Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarrimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.







## DIPLOMACI INTERVISTA

Ish-anëtari i Parlamentit European flet për emisionin "Diplomaticus"

# Stevenson: Në Iran ka ekzekutime më shumë se në çdo vend tjetër të botës

"Muxhahedinët, populli shqiptar ka një zemër të madhe"

Erion Kaçorri

**S**ruan Stevenson është ish-anëtar i Parlamentit Europian dhe kryetar i Delegacionit të Parlamentit Europian për Marrëdhëniet me Irakun (2009-2014). Ai ishte këtë javë në Tiranë, në kuadër të vizitës së delegacionit të PE, që përbëhej nga Tunne Kelam, anëtar i komitetit të punëve të jashtme dhe nënkryetar i intergrupit "Miqte e një Irani të Lirë" në PE, Jaromír Štetina, nënkryetar i nënkomitetit të sigurisë dhe mbrojtjes në PE.

Stevenson dha një intervistë të zgjeruar për emisionin "Diplomaticus" në "News 24".

Zoti Stevenson, Brexit është në etapën e fundit. Britania e Madhe planifikon që të largohet nga Bashkimi Europian më 29 mars 2019. Si anëtar i konservatorëve skocezë, cilat janë pritshmëritë tuaja mbi këtë temë?

Ne kemi zhvilluar negociata dyvjeçare mjaft serioze, por plani aktual që Tereza May po përpigjet të promovojë për të cilën është rënë dakord në mënyrë unanime nga 27 vendet anëtare në Bruksel nuk ka shumicë parlamentare për të në Britaninë e Madhe. Partia Laburiste në opozitë është kundër saj, partia liberale është kundër saj. Të paktën 80 deputetë janë kundër këtij plani. Partia irlandeze tek e cila mbështetet Theresa May, edhe ajo është kundër saj. Gjithashtu, partia nacionaliste skoceze është kundër planit të Theresa May.

**Cfarë ndodh atëherë?**

Ky plan nuk do të mund të kalojë në parlament. Theresa May i tha popullit britanik se ekzistojnë tri opsione. Ose ecet përpara me marrëveshjen time, ose nuk ka marrëveshje, ose nuk ka Brexit. Personalisht do të preferoja të mos ketë Brexit, sepse Skocia votoi me shumicë të madhe kundër daljes së Britanisë nga Bashkimi Europian. Uellsi votoi në favor të Brexit-it. Irlanda e Veriut votoi kundër Brexit-it. Ka një tregues të qartë në sondazhet e fundit në Britaninë e Madhe se nëse do të kishin një referendum të dytë, do të votonin që të qëndrojnë në Bashkimin Europian. Ka një lëvizje të madhe, më shumë se një milion njerëz që kërkojnë një referendum të dytë. Duke u përballur me një parla-



Sruan Stevenson, ish-anëtar i Parlamentit Europian dhe kryetar i Delegacionit të Parlamentit Europian për Marrëdhëniet me Irakun (2009-2014)

ment që nuk e mbështet, Theresa May ka opsionin për të kërkuar zgjedhje parlamentare, të cilën ajo nuk do e bëjë, sepse ka frikë se mund të humbasë shumicën përballë Jeremy Corbyn i partisë laburiste, ose të thërrasë një referendum të dytë. Unë mendoj se një referendum i dytë është shumë pranë.

**Nëse plani aktual i Brexit realizohet, çfarë ndodh me Skocinë?**

Fatmirësisht unë nuk jam nacionalist dhe fatkeqësisht e gjithë kjo zhurmë ka qenë një dhuratë për nacionalistët, të cilët thonë se nëse Skocia do të ishte e pavarur, mund të qëndrojnë në Bashkimin Europian. Por nëse e shikojmë sasa e vështirë është për Britaninë e Madhe që të largohet nga Bashkimi Europian, një klub në të cilin është anëtar prej 45 vitesh, imagjinoi sa e vështirë është për Skocinë që të largohet nga Mbretëria e Bashkuar, ku jemi anëtar prej 300 vjetësh. Do të ishte diçka e tmerrshme. Ne bëjmë pesë herë më shumë tregti me Anglinë sesa me pjesën tjetër të Europës. Nga ana ekonomike do të ishte katastrofike. Nëse Skocia do të bëhej e pavarur, do të kishte një deficit më të madh se Greqia dhe nuk mendoj se Bashkimi Europian do të na mirëpriste ne si anëtar me gjithë këtë deficit.

**Por, a parashikohet të ketë një tjetër referendum për pavarësi nga skocezët?**

Sigurisht që nacionalistët janë në pushtet në Skoci dhe ata e duan një tjetër referendum. Unë personalisht bëj fushatë kundër tij. Bizneset dhe industria ka nevojë për stabilitet dhe pasiguritë që krijohen nga Brexit janë mjaftueshëm. Kjo do të shkatërronte vendet e punës dhe ekonominë skoceze. Ekonomia skoceze nuk po performon aq mirë sa pjesa tjetër e Britanisë së Madhe, për shkak të

Europian u takua me kryeministrin tuaj. U kthym në Bruksel dhe deklarua se populli i Shqipërisë ka një zemër të madhe. Ata kanë pranuar refugjatët iranianë që të jetojnë në Shqipëri në një kohë kur asnjë vend i Europës nuk ishte i përgatitur ta bënte këtë. Populli shqiptar dëshiron të bëhet vend anëtar i Bashkimit Europian dhe ne duhet ta vendosim këtë vend në listë, sepse dëshira për anëtarësim

### ANETARËSIMI

Populli i Shqipërisë ka një zemër të madhe. Ata kanë pranuar refugjatët iranianë që të jetojnë në Shqipëri në një kohë kur asnjë vend i Europës nuk ishte i përgatitur ta bënte këtë. Populli shqiptar dëshiron të bëhet vend anëtar i Bashkimit Europian dhe ne duhet ta vendosim këtë vend në listë, sepse dëshira për anëtarësim atje është e madhe.

kërcënimeve për referendume të tjera mbi pavarësinë.

**Zoti Stevenson, në një kohë kur Britania e Madhe kërkon që të largohet nga Bashkimi Europian, vendet e Ballkanit duan të anëtarësohen në Union. Si e shikoni ju këtë çështje?**

Për herë të parë kur erdha në Shqipëri katër vite më parë dhe u takova me ministrin tuaj të Jashtëm, kolegu im, i cili është zëvendës-president i Parlamentit

atje është e madhe. Ju e keni vendosur veten në hartën ndërkombe-tare, duke strehuar disidentët nga Irani.

**Duke qenë se e hapët këtë temë, si e shikojnë ndërkombëta-aret vendimin e Shqipërisë për të pranuar kaq shumë njerëz nga Irani?**

Ne tashmë e dimë se amerikanët kanë ndryshuar tërësisht politikën e tyre ndaj Iranit nën presidencën e Donald Trump dhe



Sruan Stevenson në emisionin "Diplomaticus", në "News 24"

sekretarit të shtetit, Mike Pompeo. Ata e kanë grisur marrëveshjen bërthamore, për të cilën kishte punuar fort ish-presidenti Obama. Marrëveshja bërthamore është diçka për të cilën Bashkimi Europian shpreson ende se do të vazhdojë. Arsyetja për këtë është se Europa bën shumë biznes me Iranin. Atyre u pëlqen të nënshkruajnë kontrata fitimprurëse duke mbyllur sytë për shkeljen e të drejtave të njeriut.

**Kjo është akuzë e rëndë ndaj BE-së.**

Irani ka rekordin më të keq të ekzekutimeve krahasuar me çdo vend tjetër të botës për banor. Në Iran ekzekutohen më shumë njerëz se në çdo vend tjetër të botës. Ata ekzekutojnë më shumë se në Kinë. Ata i burgosin njerëzit vetëm se janë disident politikë. Ne kemi fakte, të cilat i posedojnë Kombet e Bashkuara. Që në vitin 1998 ata masakruan 30 mijë muxhahedinë iranianë, të cilët janë disidentë. Ata madje e pranojnë këtë. Ish-ministri iranian i Drejtësisë, Mostafa Pourmohammadi deklaroi se ndihet krenar që i ka vranë këta njerëz. "Unë po bëja punën e Zotit", shprehet ai. Njerëz të tillë duhen gjykuar për krime kundër njerëzimit. Kjo është një nga mizoritë më të rënda. Ata vranë 30 mijë disidentë politikë dhe u përpoqën të shfarosin njerëzit që ndodheshin në kampin Ashraf në Irak. Më pas këta njerëz i dërguan në kampin e përqendrimit, i quajtur kampi "Liria" në mënyrë ironike, duke u përballur me sulmet me raketa. 168 për tërësi u vranë dhe më shumë se 1700 u plagosën dhe asnjë vend i Europës nuk pranoi që t'u jepte këtyre njerëzve një strehë të sigurt. Asnjë vend nuk pranoi që t'i ndihmojë përveç Shqipërisë. Shqipëria e dinte se çfarë do thotë të jetosh nën shtypjen e komunizmit për shumë vite. Shqipëria e dinte se çfarë do të thotë të përballesh me tiraninë duke u dhënë këtyre njerëzve një shtëpi. Ju treguat se keni një zemër të madhe. Si skocez, e vlerësoj shumë veprimin tuaj. **Përmendët kampet e përqendrimit. Na kujton masakrat e Luftës së Dytë Botërore. Si anëtar i Parlamentit Evropian, keni qenë reporter për**



## MARRËSVESHJA

Marrëveshja bërthamore nuk ishte e mirë. Obama dëshpërimisht kërkonte që të linte shenjë e tij në histori, sepse nuk kishte arritur asgjë në skenën ndërkombëtare pas qëndrimit në detyrë për dy mandate presidenciale. Kështu, ai dërgoi John Kerrin, sekretarin amerikan të shtetit në Vjenë duke i kërkuar që të qëndronte atje për gjashtë muaj deri sa të arrinte nënshkrimin e marrëveshjes.

← **Irakun. E keni vizituar këtë vend. Cfarë dëshmuat atje në lidhje me anëtarët e opozitës iraniane, që ishin strehuar në Irak?**

Në kampin Ashraf, në veri të Irakut ekzistonte një kompleks shumë i madh dhe pasi amerikanët u larguan nga Iraku duke ia dorëzuar sigurinë popullit të këtij vendi, irakianët e rrethuan kampin Ashraf, mbyllën portat dhe nuk lejuan njeri që të largohej prej aty. Ata nuk lejonin hyrjen e mjekëve, nuk lejonin dërgimin e pacientëve nëpër spitale. Muxhahedinët përballshin me sëmundje të rënda si kanceri, por i linin ata që të vdisnin nëpër kampe. Më pas, ata nisën që të sulmojnë kampin duke dërguar edhe batalione me ushtarë të armatosur rëndë apo tanket kundër njerëzve, burrave dhe grave e duke vrarë njerëz të pafajshëm. Por duke qenë një kamp i madh, shumë nga këta njerëz arritën të fshiheshin duke shpëtuar. Ish-kryeministri Nuri Al Maliki ishte marioneta e qeverisë iraniane, e cila i kërkonte atij që t'i zhvendoste këta njerëz në kampe më të vogla, në kampet e vdekjes për t'i vrarë të gjithë. Pra, duke përdorur kërcënimet dhe shantazhet dhe duke bërë që edhe OKB-ja të ndihmonte për t'i detyruar ata që të largohen nga kampi Ashraf dhe duke vjedhur gjithçka brenda kampit; duke vjedhur ndërtesat e automjetet dhe duke i futur njerëzit në një kamp të vogël pa mbrojtje dhe duke u përballur shumë shpejt me sulmet me raketa.

**Zoti Stevenson, si e shikoni të ardhmen e marrëveshjes bërthamore. Bashkimi European dësh-**

**ron që të vazhdojë përpara me këtë marrëveshje, Shtetet e Bashkuara nuk e duan?**

Marrëveshja bërthamore nuk ishte e mirë. Obama dëshpërimisht kërkonte që të linte shenjë e tij në histori, sepse nuk kishte arritur asgjë në skenën ndërkombëtare pas qëndrimit në detyrë për dy mandate presidenciale. Kështu, ai dërgoi John Kerrin, sek-



retarin amerikan të shtetit në Vjenë duke i kërkuar që të qëndronte atje për gjashtë muaj deri sa të arrinte nënshkrimin e marrëveshjes. Por, fatkeqësisht përmes marrëveshjes lëvroheshin njëqind e pesëdhjetë miliardë dollarë asete të ngrira, që iu kthyen iranianeve dhe ata i përdoren këto para për të financuar Bashar Al Assadin, për të vazhduar luftën civile atje. I përdoren këto para për të financuar

Ish-deputeti i PE: Plani i Raxhavit, fund konfliktit në Lindjen e Mesme

# "Brexiti? Skocia e ka të vështirë të largohet nga Mbretëria e Bashkuar"

## "Nacionalistët në pushtet duan një tjetër referendum"

### TAKIMI ME RAJAVIN

Delegacioni i PE, duke përmendur deklaratën e përbashkët të 150 anëtarëve të Parlamentit European, e cila dënon abuzimet e regjimit iranian me të drejtat njerëzore brenda vendit dhe komplotet e tij terroriste në Europë, shprehu mbështetjen e tij për MEK.

rebelët Huthi në Jemen, për të financuar Hezbollahun në Liban, për të financuar milicët shiite në Irak, kështu që gjithçka që ka arritur marrëveshja bërthamore është përhapja e ndikimit negativ të Iranit në Lindjen e Mesme me më shumë akte dhune.

**Zoti Stevenson, muxhahedinët tashmë jetojnë në Shqipëri dhe ju sapo keni vizituar kompleksin e tyre, që duket se është i fortifikuar. Nuk ka shumë informacion mbi këtë kompleks. Cfarë mund të na tregoni ju për këtë?**

Ata janë zhvendosur në këtë ndërtesë nëntorin e kaluar dhe brenda një viti kanë ndërtaur pothuajse një qytet të vogël. Është e pabesueshme.

**Ndodhet në Manzë apo jo?**

Kanë marrë hua miliona dollarë për të ndërtaur këtë qytet dhe po mbledhin paratë nga mbështetësit e tyre në të gjithë botën për të shlyer borxhet.

**Përse duhet të ndërtojnë një qytet?**

Sepse janë 2500 njerëz. Ata janë refugjatë dhe nuk kanë se ku tjetër të shkojnë. Ata nuk kanë pasaporta. Nëse do të ktheheshin në Irak, do të çekzoktoheshin. Ata duhet të jetojnë diku. Janë njerëz shumë inteligjentë, janë doktorë shkencash, njerëz shumë të aftë dhe këtë mund ta shikosh me mënyrën si e kanë ndërtaur kompleksin e tyre.

**A mund të na tregoni për vizitën tuaj atje?**

Dy agjentë iranianë u arrestuan pas tentativës së tyre për të shpërthyer një autobombë në vendin ku muxhahedinët iranianë jetonin në Tiranë dhe ata u dëbuan nga qeveria juaj duke i kthyer në Iran. Është për të ardhur keq që nuk morën burgim të përjetshëm. Pra, këta njerëz duhet të kenë siguri. Kampi është i hapur. Njerëzit brenda tij hyjnë dhe dalin për aktivitetet e tyre, për të bërë blerjet e nevojshme në Manzë apo në Tiranë. 700 familje të cilat nuk lejoheshin të vizitonin të afërmit e tyre në Irak për vite me radhë, sot vijnë në Shqipëri për të takuar djemtë dhe vajzat e tyre. Politikanë si unë që na ndalohej t'i vizitonim ata në Irak, sot kemi mundësinë që të vijmë në Shqipëri për t'i takuar. Kam qenë këtu me anëtarët e lartë të delegacionit të Parlamentit Evropian dhe në këtë kamp janë më shumë se 200 shqiptarë, të cilët

Sepse në besojmë në liri, drejtësi dhe e shikojmë se çfarë ndodh në Iran. Regjimi i mullahëve është i korruptuar, një regjim vrasës. I gatshëm për të vrarë sa më shumë kundërshtarë.

**A është organizata MEK alternativa e vetme për Iranin?**

Ata janë një opozitë shumë efektive e drejtuar nga një grua, nga zonja Marian Razhavi, e cila ka qenë këtu në Shqipëri disa herë. Ajo është një zonjë e jashtëzakonshme. Ajo ka një plan me dhjetë pika për të ardhmen e Iranit, që është përshkruar nga njerëz si Rudy Giuliani, avokati i presidentit Trump, si një plan i tipit Jefferson. Është një manifest që ofron liri dhe drejtësi. Ofron fundin e dënitimit me vdekje, ofron fundin e torturave dhe kërcënimeve bërthamore dhe fundin e konfliktit në Lindjen e Mesme. Të gjithë këtë duan.

**Besoni se demokracia mund të ekzistojë në Lindjen e Mesme?**

Ka qenë rrugë e vështirë për t'u arritur kjo, por populli në Iran, persët, janë një popull shumë i sofistikuar: Rreth 60 për qind e popullatës prej 80 milionë banorësh në Iran janë nën moshën 30 vjeç dhe shikojnë sesi vendi i tyre është shndërruar në një shtet të përjashuar për shkak të tiranëve që udhëheqin Iranin dhe ata duan që të bëhen pjesë e komunitetit ndërkombëtar. Ata duan të jenë një vend normal dhe jo një vend që nxit konflikte, një vend që diskriminon sunitët vetëm sepse shumica është shiite, apo një vend që diskriminon të krishterët vetëm sepse nuk ndjekin rrugën e Sheriatit. Është një regjim vrasës dhe nëse e zhdukim atë dhe vendosim një forcë demokratike të drejtuar nga zonja Maryam Rajavi, do të sjellim paqen jo vetëm në Lindjen e Mesme, por edhe në botë.

**Zoti Stevenson, keni qenë ndonjë herë në Iran?**

Nëse do të shkoja në Iran, nuk do të kthehesha dot. Ndodhem në listën e tyre të zezë. Nuk do të isha këtu duke biseduar me ju. Kam qenë disa herë në Lindjen e Mesme, por jam treguar i kujdesshëm për të mos kaluar në pjesën e Iranit, përndryshe gjërat do të ishin përndryshe me mua.

punojnë çdo ditë dhe kjo ka nxitur ekonominë lokale të zonës. Është diçka e mirë për Shqipërinë dhe siç e thashë, ju shqiptarët keni zemër të madhe duke i mirëpritur këta njerëz. Kjo ka qenë diçka shumë e mirë për reputacionin e Shqipërisë.

**Ka kuriozitet nga publiku. Pse kaq shumë mbështetje nga disa politikanë europianë dhe amerikanë për muxhahedinët iranianë?**

BOTIMI

# Namik Dokle:

## "Ditët e lakuriqëve të natës", kur të ndalojnë të duash

Fatmira Nikolli


S i jetohej kur të ndalojnë me dhunë të dashurosh? Çfarë ngjyre ka qielli, dielli, yjet dhe lulet? Ç'shije ka ajri, uji, puthja e munguar, përvëlmi i trupit në dëshirë? Ngjyrat dhe shijen e tërbimit - na e thotë Namik Dokle me romanin e tij "Ditët e lakuriqëve të natës". Studiuja Anna Kove, e nis me këto pyetje shënimin e saj për romanin më të ri të Namik Dokles, "Ditët e lakuriqëve të natës". Thotë se subjekt i këtij romani shtillet rreth një fabule mbresëlënëse: sëmundja që po merr jetën e të rinjve nuk është "tërbim" i ardhur nga shkaqe që mund t'i shpjegojë shkencën. "Ajo vjen nga ndalimi që u bëhet të rinjve të mos kenë asnjë mundësi të bëjnë dashuri. Në fshat mbizotëron një shtettrrethim i frikshëm mbi ndjesitë dhe nevojat shpirtërore dhe fiziologjike të të rinjve. Personazhet kanë veshur, të gjithë, petkat e tyre prej fjalësh të frikura dhe luajnë para syve tanë dramën e tyre, që është njëkohsisht drama e gjithë shoqërisë shqiptare në diktaturë. Hesh-tja e frikshme mes banorëve për të artikuluar dyshimet, e pengon një profesor shkencëtar të njihet shpejt me të vërtetën", shënon Kove. Për të, laboratorit i tij nuk është thjesht shkencor, por kryesisht njëzëror. Në këtë roman, ashtu si edhe në dy paraardhësit e tij, autori Dokle ka lëmuar mjeshtrërisht fjalorin e pasur të zonës; legjendat dhe mitet, realitetet magjike janë sërish pjesë domethënëse e rrëfijës së autorit, i cili tashmë e ka të shtruar si kall-drëm, me gurët e skalitur, udhën e sigurt drejt lexuesit dhe letërsisë së bukur shqipe.

Për studiuesin Behar Gjoka, "Ditët e lakuriqëve të natës", krahas dy romaneve të mëparshme, plotëson triptikun romanor të Namik Dokles, shënjon vlerë të letrave shqipe. Gjashtë ditët e kohës letrare, që sipas Gjokës vijjnë përmes digresionit, japin shkërmqjen e ëndrrave. Në fshatin e dashurisë së shprehur me lule, ka rënë tërbimi. Për ta qartësuar mjegullën absurde shkon biologu. Ai vëren se kujtesa e përmbytur e linjave, narativës dhe simbolikës, së lakuriqëve dhe dhelprave të kuqe, plazmojnë magjikën e tjetërsimit të qenies. Kilapia e zhgëndrës, derdhur si "ironi intertekstuale" e Eco-s, është zbulosa e vrasjes së dashu-


risë, aty ku njeriu i ri, i Partisë dhe i Sigurimit, shkel me këmbë dijetarin, dëshmon rebusin letrar...

Namik Dokle lindi në Durrës, më 11 mars të vitit 1946. U diplomua në Universitetin Buqësor, dega ekonomi agrare (1965-1970) si dhe në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Gazetarisë (1968-1970). Fillimisht punoi si gazetar, por që prej viti 1991 u bë i njohur si politikan në parlamentin shqiptar. Krijimtaria e tij letrare është pasur me tregime, drama, radiodrama, publicistikë dhe së fundi ka lëvruar edhe romanin.

TRI FRAGMENTE NGA LIBRI  
Edhe unë jam si këta lakuriqët, jam rrasur në një shtëpi të braktisur dhe akoma nuk di se çfarë bëj, mendoj profesor Reka. Pastaj e pyeti Sejdon pse ishte aty dhe ai i tregoi se donte të shikonte nga afër lakuriqët e ardhur nga miniera e shembur. Të gjitha dhomat pa diell janë plot, i tha, dhe po vijnë edhe të tjerë, disa kanë ngordhur, të tjerë bien në mes të rrugës, pa arritur në strehën e tyre të re. Gjithë shoqësimi i profesorit ishte lloji i lakuriqëve, nëse ishin hematofogë ose jo. Po të ishin "gjakpirës" dhe jo insektengrënës, sqaroi ai, gjithë ajo luzmë qindralakuriqshe do të



mjaftonte për të tërbuar jo një, por shtatë apo shtatëdhjetë fshatra. Por shumë shpejt Sejdo e qetësoi. Kish-të dy orë që i vëzhgonte dhe nuk kish-të parë asnjë lakuriq gjakpirës. Me një shkop të gjatë që e mbante në dorë goditi një nga ata që fluturonin qorrazi rreth tyre dhe e kapi me duarve, i hapi gojën dhe i tregoi profesorit që lakuriqi nuk i kishte dhëm-



bët si të vampirit, ky nuk kafshon, ky lloj gëlltit insektet, i tha. "Lëshoje!", i thirri profesori. "Mund të kete rrezatim."

Sejdo e dëgjonte për herë të parë atë fjalë.

\*\*\*

"Çdo popull ka sindromën e vet", i pat thënë një koleg, me të cilin ishin bashkë në një konferencë shkencore. "Çdo gjë varet nga koha kur kupton atë që ka." "Kush ia zbulon?", pati pyetur profesor Reka. "Është e çuditshme", i tha kolegu, "sikur jemi të vegjël dhe presim dikë tjetër të vijë e të na tregojë. Japonezët e zbulojnë në Francë, francezët në Firence. Rusët as nuk e dinë sindromën e tyre, që e ka zbuluar një japonez, nuk e mbaj mend emrin."

"Çfarë ka zbuluar ai?"  
"Historinë siberiane, lodhjen dhe frikën nga një pamje, që nuk ndryshon kurrë..."

"Mendo për sindromën tënde!", u tall me veten dhe nuk dinte ç'të bënte, të futej në rroba si viktimë e tartabiqeve, apo të dremiste mbështetur në karrigen e shtrembër që i kishin sjellë nga zyra e llogaritarrit të kooperativës.

\*\*\*

Po kujtonte një këngë që e kish-të kënduar ndoshta njëqind apo një

milion vjet përpara, për një dashuri fatkeqe a për një nënë kobzeze që gënjue djalin e vet për nusen e tij të re... sa ishte ti në ato toka të djemtë e rinj, shkonte në plemat e vejanëve, rrinte natën vonë në dritare. E djali u turbullua dhe nxori thikën, i tërmegji sytë që i lotonin gjak, i preu kokën nuses së vet të re e të bukur si lulja e shëgjit, kuqbardha e Shëngjergjit. Koka e prerë e nuses aty në skaj të shtratit i foli dhe i tha: shiko trarët tjetër të vijë e të na tregojë. Japonezët e zbulojnë në Francë, francezët në Firence. Rusët as nuk e dinë sindromën e tyre, që e ka zbuluar një japonez, nuk e mbaj mend emrin."

"Çfarë ka zbuluar ai?"  
"Historinë siberiane, lodhjen dhe frikën nga një pamje, që nuk ndryshon kurrë..."

"Mendo për sindromën tënde!", u tall me veten dhe nuk dinte ç'të bënte, të futej në rroba si viktimë e tartabiqeve, apo të dremiste mbështetur në karrigen e shtrembër që i kishin sjellë nga zyra e llogaritarrit të kooperativës.

\*\*\*

Po kujtonte një këngë që e kish-të kënduar ndoshta njëqind apo një

### VENDIMI I MINISTRISË SË KULTURËS PËR KAMPIN E TEPELENËS

Ministria e Kulturës ka miratuar projektin "Memoriali i fëmijëve Mitë Vdekur në kampin e internimit Tepelenë (Pjesë e kompleksit muzeal të kampeve në diktaturë)". Vendimi i saj materializon përpjekjet e deritanishme të Autoritetit për Informim mbi Dosjet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për muzealizimin e Kampit të Tepelenës, të kuadër të projekteve të kujtesës të ndërmarrja nga ky Institucion. Ky projekt përmban rikthimin në identitet, si kamp dëbimi të një prej kapanoneve, dizenjimin, pozicionimin dhe mbjelljen e 300 fidanëve (qiparisa) në përkujtim të fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në Kampin e Tepelenës dhe janë pa një vendvarrim. Ndërtimi i këtij memoriali shënon vetëm hapin e parë për transformimin e të gjithë kompleksit në një Muze të Kampeve të Punës së Detyruar të Diktaturës Komuniste. Për të realizuar këtë projekt AIDSSH ka firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me partnerë, të cilët ndihmojnë në mbledhjen e dokumenteve dhe të dhënave zyrtare si dhe në ndërgjegjësimin qytetar dhe edukimin shoqëror, nëpërmjet rishqyrtimit të historisë dhe rivlerësimit të saj. Për mbledhjen e dokumenteve zyrtare që faktojnë periudhën e ekzistencës së Kampit të Tepelenës është

bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me Institutin e Integritimit të Përndjekurve Politikë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Për të realizuar këtë projekt AIDSSH ka firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi me partnerë, të cilët ndihmojnë në mbledhjen e dokumenteve dhe të dhënave zyrtare si dhe në ndërgjegjësimin qytetar dhe edukimin shoqëror, nëpërmjet rishqyrtimit të historisë dhe rivlerësimit të saj. Për mbledhjen e dokumenteve zyrtare që faktojnë periudhën e ekzistencës së Kampit të Tepelenës është bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, me Institutin e Integritimit të Përndjekurve Politikë, Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri. Në këtë kuadër, projekti është mbështetur nga Bashkia e Tepelenës dhe partnerë të AIDSSH, si PNUD, OSBE e institucione të tjera, publike, akademike dhe të kërkimit shkencor. Me Muzeun Kombëtar të Kampeve të Punës në Tepelenë, AIDSSH synon të krijojë një model për të gjitha kampet e punës së detyruar në Shqipëri, ku e shkuara të shërbejë për reflektim e të mos përsëritet.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 637

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHOIPTARE Redaktore: Pamela Allaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 1 Dhjetor 2018

## XHELOZI E SEMURE?



### Zbulohet shkaku i ndarjes së lidhjes treshe të Eglës Harxhit

S'e prisnim!  
Era Istrefi  
dhe Julian  
Perreta  
të lidhur  
**JA PROVAT**



## Rike Roçi fiton audicionet për aktore



## XHENSILA PERE

### Zbulohet më në fund i dashuri?






**Rrëfëhet ish-misi shqiptar: Nuk dua të hedh baltë mbi të kaluarën**

# Xhelozi e sëmurë? Zbulohet shkaku i ndarjes së lidhjes treshe të Eglja Harxhit

Pamela Aliaj

**E**dhe pse kanë kaluar vetëm 2 vite nga buja që bëri deklarata e ish-misit shqiptar, Eglja Harxhi, lidhur me statusin e saj për një lidhje treshe, tashmë gjithçka ka ndryshuar. Para pak kohësh ne zbuluam edhe se vajza, Alesia, që ishte pjesë e kësaj tresheje kishte gjetur dashurinë diku tjetër. Po flasim pikërisht për lidhjen treshe që modelja kishte së bashku me partnerin francez, Jarl de Basserville dhe modelen nga Ballkani, Alessia. Por, pavarësisht bujës dhe zhurmës së madhe që ajo bëri në median rozë, si edhe në mbarë opinionin shqiptar, duke qenë se nuk është mësuar me staturë të tilla, kjo lidhje nuk zgjati shumë. Vetëm pas dy vitesh erdhi në jetë fryti i dashurisë së modelës shqiptare me francezin Jarl. Luxifer, ose i quajtur ndryshe, sjellësi i dritës, ishte shkaku i ndarjes së treshes dhe mesa duket ai ishte! Në një intervistë të mëparshme për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", ishte vetë Eglja, e cila për herë të parë na pohoi ndarjen e të treve për të nisur një jetë të re në krahë të vogëlulshit. Por, ç'ndodhi me Alessian? Pse në të vërtetë u largua ajo? E pyetur për këto

*Jetonte në gjendje të mjerueshme dhe depressive, e vërteta e jetesës së Alessias me çiftin*





informacione për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Egla është shprehur se nuk do të hedhë baltë mbi të kaluarën, por nuk mohon por as nuk konfirmon informacionet duke na lënë të dyshojmë se ndoshta kjo ka qenë vërtetë arsyeja e ndarjes. Dhe arsyeja e ndarjes sipas burimeve të "Gazeta Shqiptare", një e afërme e Alessias, e cila ka ndjekur nga afër marrëdhënien e saj me Egla Harxin dhe Aleks de Basseville shprehet se Alessia ishte një vajzë e cila jetonte në kushte të mjerueshme dhe gjendje depressive. Nga dashuria dhe dëshira për ta ndihmuar, Egla e mori në mbrojtje duke i ofruar gjithçka, roba, mësim mbi mirëmbajtjen, vizita mjekësore, udhëtimet në Francë. Në momentin kur Egla ngeli shtatzënë, Alessia ka bërë kriza xhelozie, por me kalimin e kohës Egla e qetësoi duke i thënë se ajo është pjesë e familjes dhe se fëmijën do e rrisnin bashkë. Në fillim duket sikur Alessia u qetësua, por sa më shumë kalonin muajt, aq më shumë rritej xhelozia. Alessia është përpjekur disa herë të ndajë çiftin, thotë burimi për "Gaze-

ta Shqiptare", duke krijuar probleme midis tyre, por pa rezultat sepse mbas gjithë dashurisë që ju dha, dhe dëshira e madhe për ta ndihmuar që Alessia të zhvillohej në një ambient pozitiv, mosmirënjohja e Alessias arriti kulmin duke i kërkuar Ales që të lë Eglen dhe fëmijën për të. Kjo bëri që Egla dhe Aleks të vendosnin ta largojnë përfundimisht nga jeta e tyre. Kjo shpjegon edhe postimet e Egles në "Instastory". Ndërkaq kujtojmë që më parë, "Gazeta Shqiptare" zbuloi një foto të Alessias, e cila nga ana e saj dukej se kish vazhduar më tej me jetën e saj. Në foton e profilit të saj shfaqet duke u puthur me një mashkull me tatu. Ndërkaq kujtojmë se para dy vitesh, modelja shqiptare tërhoqi për herë të parë vëmendjen e medias me një postim të saj in nudo në një nga revistat franceze. "Miss Shqipëria" e vitit 2007 ka gjetur ditën e flamurit për të publikuar një fotografi provokative.



loyalty is a privilege,  
NOT a right...  
i don't owe you SHIT  
but i do stuff because i care  
NOT because i have to,  
some people forget that.

YOU SEE  
A PERSON'S  
**TRUE COLORS**  
WHEN YOU ARE  
NO LONGER  
BENEFICIAL TO  
THEIR LIFE.

#ungratefulpeople and  
#opportunists



Alesia Egla Harxhi

The same people you  
helped move forward  
will be the same ones to  
be disloyal to you. Then  
will need your help again  
eventually when they  
are stuck...Karma

## Aktori i "Portokallisë" shfaqet i dashuruar si kurrë më parë me të dashurën

Ai ka folur edhe më parë për të, por tashmë duket se aktori i njohur i "Portokallisë" Rezart Veleshnja duket se nuk e fsheh më historinë e tij të dashurisë dhe aq më pak lumturinë që po ndjen në këto momente. Së fundmi ai ka publikuar një foto në rrjete sociale në të cilën shfaqet duke u përqaftuar me të dashurën e tij, duke u kujdesur që të mos i ekspozojë fytyrën, por, në fakt, që më parë ai e ka shfaqur vajzën që i ka rrembyer zemrën në një status në 'Instagram'. Nuk është hera e parë që Rezarti publikon foto të tilla me të dashurën duke treguar kështu dashurinë mes tyre.



## Kush është Kim? Këngëtarja shqiptare mban shishen me të pasmet bombastike

Të gjithë e mbajmë mend boom-in që bëri fotoja e famshme e Kim Kardashian në revistën e njohur "GQ" duke shfaqur të pasmet e duke mbajtur një gotë mbi to. Por mesa duket këtë gjë ka dashur ta bëjë dhe dikush tjetër. Ana Kabashi, këngëtarja nga Kosova dallon për linjat e saj perfekte përveçse zërit. Këngëtarja ka forma të cilat çdo femër do t'i dëshironte. Ka qenë pikërisht kjo këngëtare e cila ka befasuar



me një ushtrim interesant nga palestra, tekta bënte 'squats', Ana kishte vendosur një shishe në të pasmet 'bombastike', e cila nuk lëvizte fare. "Mbaje atë shishe për mua" ka shkruar Ana. Pra, kush ishte dhe një herë Kim? Edhe Ana mund ta bëjë!



## Më sensuale se kurrë, ORINDA poston foto nga vaska

Ajo i përditëson shpesh ndjekësit e saj me foto nga puna e përditshme, por kësaj radhe ka ardhur ndryshe. Moderatorja dhe këngëtarja Orinda Huta ka publikuar në rrjete sociale disa foto ku shfaqet mjaft sensuale. Në këto foto Orindën e shohim në një vaskë, por e veshur më në formë dhe seksi se asnjëherë. Aktualisht ajo është drejtuar emisionin "Jo vetëm modë" në Klan si dhe është pjesë e jurisë për të rinj të edicionin e 20-të të "Kënga Magjike". Vërtet e ëmbël dhe tërheqëse Orinda!

## I dolën të brendshmet në Kuvend, deputetja çudit me deklaratën

Para disa ditësh, deputetja e Kuvendit të Kosovës, Dude Balje ishte në qendër të vëmendjes me veshjen e saj ku i dukeshin të brendshmet. Ajo shpesh provokon me veshjen e saj, tekta rasti i fundit ishin të brendshmet e saj, të cilat u panë nga të gjithë në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazisë Gjinore, Personave të Pagjetur dhe Peticioneve. E ftuar në programin "Ftesë në 5", deputetja lidhur me këtë ngjarje u shpreh: Jam e bukur sepse, jam e kënaqur me veten kështu si jam." Ajo foli, gjithashtu, për familjen e saj, pasi është nënë e tre fëmijëve, tekta tregoi se ka pasion palestrën. Kujtojmë se ajo fillimisht u komentua shumë në lidhje me veshjen në Kuvendin e Kosovës, tekta pritet provokimi i saj i radhës. Pra s'është aspak problem për deputeten një veshje e tillë.





## Surprizon **STRESI**, telefonon “Aldo Morning Show” nga burgu me një mesazh prekës për Kejsin

P prej kohësh është vendosur në qendër të vëmendjes nga mediat rozë reperi Stresi për shkak të arrestimit të bujshëm në dhomën e një hoteli në Linzë me një 20-vjeçare. Familjarët e tij e konsideruan arrestimin e të birit si të nxitur politikisht. Lidhja e tij dashurore me Kejsi Buzhanin u komentua gjatë, por kjo e fundit ka treguar se i qëndron atij në krah pavarësisht gjithçkaje. “Bad boy” ashtu siç e etiketon ai veten, është bërë sërish i gjallë mëngjesin e sotëm në emisionin “Aldo Morning Show”. Ai telefonoi nga burgu për ta përshëndetur dhe për t’i bërë të ditur që së bashku me 450 të burgosur të tjerë po e ndiqnin emisionin e mëngjesit. Stresi publikoi edhe videon e bisedës së tyre në ‘Instagram’, si për të treguar se ka akses të plotë në internet falë telefonit që zotëron në qeli. Reperi Stresi ka përshëndetur të gjithë fansat e tij, por nuk ka lënë pa përmendur dhe dashurinë e tij të zemrës. ‘Si me grep’ Aldo i ka nxjerrë një mesazh kushtuar bashkëshortes së tij, Kejsit, që tashmë jeton në Kanada. “Mos u dorëzo, sepse do të shihemi shumë shpejt”, - është shprehur Stresi. Ai gjithashtu ka treguar se nuk do të jetë pjesë e ‘Këngës Magjike’ në gjysmë-finale, por me shpirt do të jetë atje. Stresi pohoi se është duke pritur amnistinë që mund të ndodhë me rastin e festave të fundvitit, si dhe beson në drejtësinë shqiptare, për të qenë sërish i lirë. Ai u arrestua në një hotel në Tiranë ku iu gjenden lëndë narkotike si dhe armë.



## Së shpejti do bëhet baba, moderatori publikon fotografitë e ëmbla me bashkëshorten

Vetëm para disa muajsh moderatori i njohur, Labinot Gashi, zbuloi se do të bëhej baba për herë të parë. Sigurisht që emocionet për të dhë bashkëshorten e tij janë të mëdha dhe këtë Labi e ka treguar shpesh. Bashkëshortja e moderatorit, Qëndresa, është në javët e fundit të pritjes së ëmbël dhe për ta patur gjithmonë kujtim këtë moment të veçantë në jetën e tyre, ata kanë bërë edhe disa fotografi. Labi i ulur në gjunjë përpara bashkëshortes së tij, shihet duke puthur barkun e saj dhe pavarësisht se fëmija i tyre nuk ka ardhur ende në jetë duket si një portet i bukur familjar. Përkrah fotografisë Labi ka shkruar: “I bekuar”. Së fundmi Labi ka zbuluar se do të bëhet baba i një vajze. Foto më të ëmbla se këto s’kishim parë nga Labi. Një emocion i veçantë për prindërit e rinj.

## Waw s’ka ndryshuar aspak! Si dukej **EVA MURATI** në adoleshencë kur prezantonte koncertet

Bukuroshja Eva Murati, prezantuesja e emisionit “UEFA - Champions League” në Vizion Plus, është përmendur në një artikull si “Rai, MediaSet”, ku shkruhej se ajo duhet të qëndrojë “ashtu siç është, as më seksi, as shumë trendi dhe larg kontureve”. Por si dukej Eva në gjimnaz? Duke qenë se të gjithë vdesim për t’u kthyer pas në kohë, ja një foto e gjastë viteve më parë, ku ajo shfaqet duke prezantuar koncertet në gjimnazin “Petro Nini Luarasi” ku ka qenë vetë moderatoja që e ka postuar. “6 vite më parë, kur prezantoja koncertet e gjimnazit për festën e Pavarësisë. PNL numër 1!”, shkruhet në foton e postuar në InstaStory. Me po të njëjtën buzëqeshje të ëmbël që e karakterizon edhe sot, Eva duket shumë e lirshme në skenën e gjimnazit. Duket që s’ka për të ndryshuar sikur e ka në gen. Lum ajo!



## **BLENDI FEVZIU** uron Pavarësinë me flamurin e gabuar, Bes Kallaku i tërheq vëmendjen

Të shumtë kanë qenë figurat publike që uruan ditën e pavarësisë së Shqipërisë. Ndër to s’ka munguar as postimi i drejtuesit të “Opinion”, Blendi Fevziu, drejt e nga Honolulu- ja. Por më shumë se vetë urimi, vëmendjen e tërhoqi një tjetër detaj, shqijonja në flamur. Menjëherë komentues të shumtë, përfshirë dhe Bes Kallakun shkruajtën se flamuri është fallso, prodhim kinez. Për këdo që nuk arrin ta bëjë dallimin, ja ku e keni versionin original përballë atij kinez: Çështja në fjalë është vënë vazhdimisht në fokus, për vetë faktin se rastet skandaloze s’kanë patur të sosur. Të ketë qenë rastësi apo Fevziu nuk ka patur tjetër flamur në Honolulu për të valëvitur?



Zbulohet lidhja më e re e këngëtares shqiptare me artistin britanik, ja provat

# S'e prisnim! Era Istrefi dhe Julian Perreta të lidhur

Hedh pas krahëve Faton Shoshin, fotografohet me ish-të dashurin e Pamela Anderson

Pamela Aliaj

Projektet e kanë zhvendosur Era Istrefin 6800 km larg Amerikës. Por një arsye tjetër e thënë për 'Icon style' është se Era Istrefi është duke qëndruar në Londër për shkak të dashurisë. Kjo nuk ka të bëjë me Faton Shoshin, këtë histori këngëtarja e ka hedhur pas krahëve dhe këtë fotot e publikuara e vërtetojnë më së miri. Djali që i ka fituar zemrën talentit shqiptar është këngëitari britanik, Julian Perreta. Ata janë parë së bashku disa herë shumë pranë njëri-tjetrit, madje në një nga videot e publikuar nga vetë Perreta, 29-vjeçari e përshkruan Erën si princeshën e saj. Ndërsa ende nuk ka pasur një konfirmim zyrtar se janë në një lidhje dashurie, nuk duket krejt e pamundur pasi të dy janë beqar. Era Istrefi hodhi pas krahëve historinë e dashurisë me ish-menaxherin e saj Faton Shoshin, ndërsa Perreta i ka dhënë fund lidhjes me supermodelen Barbara Palvin! Ata janë pjesë e së njëjtës shtëpi diskografike 'Universal Music Group', që ka marrë përsipër karrierën muzikore të dy yjeve! Më herët, Perreta është shprehur shumë krenar për Istrefin, gjatë performancës së saj në finalen e Kupës së Botës, në bashkëpunim me Will Smith dhe Nicky Jam! Era Istrefi është një ndër vajzat më me fat shqiptare dhe ndër ato më me stil, saqë bëri që e gjithë bota të kthejë sytë nga ajo. Edhe pse zhduket për një kohë të gjatë, ajo deri tani ka shumë projekte që bota po i dëgjon si 'Bonbon', 'Redrum', 'I love Yous', 'Live it up', 'Origami', 'Oh God' dhe së




fundmi dy bashkëpunime mjaft të fuqishme 'Purpose' me Jonas Blue dhe 'Anything More' me Steve Aoki. Ndërkohë që më parë këngëtarja shqiptare ka qenë e lidhur me

ish-menaxherin e saj, këngëitari britanik përpara modeles bukurshë, Barbara Palvin është përfolur për një romancë me aktoren e njohur amerikane, Pamela Anderson. Kjo ro-

mancë ka ndodhur pikërisht në shtator të 2012, atëherë Perreta ishte vetëm 23 vjeç ndërsa seksbomba 45 vjeçe. Edhe pse u kapën në foto të dy në një mbrëmje


në Los Angeles, në atë kohë asnjëri nuk pranoi se kishte diçka mes tyre edhe pse ishin shumë intime në foto. Ndërkaq ajo që bën akoma më tepër përshtypje nga ana e këngëtarit britanik është pikërisht një ndër fotot e fundit të postuara në 'Instagram' ku ka dalë në avionin privat së bashku me Pamelën. Deri këtu ok, por ajo që ka tërhequr vëmendjen është fakti se ai e ka quajtur në mbishkrimin e fotos 'mamanë' e tij. Ndërkaq kujtojmë se Pamela Anderson ka vetëm dy fëmijë Brandon dhe Dylan nga martesja e saj e parë me bateristin e 'Scorpions', Tommy Lee. Tashmë të gjitha këto janë hedhur prapa krahëve duke qenë se të dy, si Julian Perreta ashtu dhe Era Istrefi janë duke shijuar një romancë mes tyre. Postimet e këngëtarit nëpër rrjete na kanë bërë të dyshojmë, gjithashtu, një intuitë të tillë kanë edhe ndjekësit e të dyve. Ndërkohë kujtojmë se Era Istrefi po vazhdon të realizojë projekte të reja me emra të njohur të industrisë së muzikës në botë. Era Istrefi përmes një postimi në 'InstaStory' ka konfirmuar bashkëpunimin e radhës. Bëhet fjalë për duetin me titull "Anything More", të cilin e sjell me muzikantin e njohur amerikan Steve Aoki. "Albumi i ri i Steve Aoki lansohet më 9 nëntor, ne kemi një duet së bashku që titullohet "Anything More", ka shkruar Era. Kujtojmë që projekti i fundit muzikor nga Era Istrefi është "Oh God", në duet me Konshens. Për sa i përket sërish lidhjes me Perretën, mbetet për t'u parë nëse do të kemi postime të tjera nga ata.






Pamela Aliaj

Ajo ka spikatur më parë si një nga vajzat bukurshme të "Big Brother", e cila vijon të jetë në qendër të vëmendjes edhe sot. Po flasim pikërisht për bionden seksi, Rike Roçi, e cila tashmë jeton prej kohësh në Itali. Ish-banorja njihet për pasionet e saj të shumta dhe dëshirën e guximin për t'i bërë ato realitet. Së fundmi zbuluam se ëndrra e saj më e madhe është në hapat e saj të parë drejt realizimit. Në një foto të postuar së fundmi, Rike zbulon se është duke performuar në një skenë si aktore. Por për çfarë bëhet fjalë konkretisht? Burime për "Bluetooth" të



# RIKE ROÇI

## fiton audicionet për aktore, ja ku do të nisë realizimin e ëndrrës së saj




"Gazeta Shqiptare" treguan se bukuroshja ka fituar një audicion shumë të rëndësishëm në Romë, ku nga Milano janë përzgjedhur vetëm 20 veta nga të cilët Rike ishte pjesë e tyre. Burimet thonë se bëhet fjalë për një nga akademitë më të mira kinematografike në Romë me drejtuesit më në zë të momentit. Një hap ky shumë i rëndësishëm për ish-banoren e "Big Brother". Pra, mund të mendojmë se së shpejti Rikja mund të jetë pjesë e ndonjë filmi të rëndësishëm. Të shohim ç'do mund të zbulojmë më tej.



# Zbulohet i dashuri i Xhensila Peres? Poston foto në krahë të djaloshit

Shumë herë është për folur për jetën e saj private edhe pse asgjë nuk është nxjerrë konkretisht në dritë. Nuk është e vetmja në fakt, e cila është e shënjestruar për të dalë zbuluar lidhur me personin e saj të zemrës. Po flasim pikërisht për bukuroshen Xhensila Pere, e cila së fundmi ka postuar një foto në "Instagram" dhe na ka bërë të na lindin shumë dyshime. E ulur në një biçikletë, bukuroshja mbështetet nga pas një djaloshi, emrin e të cilit nuk e ka bërë publik. Ajo që ka tërhequr akoma më tepër vëmendjen është statusi i saj, i cili është mjaftueshëm pikant për të nxitur aludime. "Jam çmendurisht e dashuruar me idenë e të qenurit në dashuri", ka shkruar ish-banorja e "Big Brother", njëkohësisht dhe misi shqiptar. Gjithashtu, ajo nuk ka dashur as të lejojë ko-



mente në këtë foto, gjë që më tepër e bën atë të dyshojmë lidhur me djaloshin. Ndërkohë që më parë ka postuar një foto ku duket duke kërcyer me një djalosh, i cili ishte vëllai i saj, kjo jo vetëm për të hequr aludimet e mediave rozë, por edhe për të bërë një dedikim të veçantë njeriut të saj të dashur. Tani, djali në këtë fo-



ton e fundit s'duket as nga larg si vëllai i Xhensilës. Pra ta përmbledhim: E dashuruar me idenë dhe nuk lejon komente është për t'i hedhur zjarr benzinës, apo vërtet më në fund pranoi të shfaqte njeriun e zemrës?



Opinion i Ditës

# Fadromat e Unazës së Re dhe modeli i zhvillimit të Shqipërisë

Nga Skënder Minxhozi

(vijon nga faqja 1)

...vitesh. Fadromat po gërrryjnë, bashkë me muret e kalburat të shtëpive e dyqaneve, kioskave e barangave, edhe rezistencën e asaj pjese të komunitetit të Unazës së Re, që kërkon kompensim të plotë financiar për ndërtimet pa leje ku ka jetuar prej dekadash. Pak po i shërben kësaj kauze lokale edhe politizimi i egër që i ka bërë projektit opozita, pasi siç shihet lodhja dhe bjerja e protestave po e bën më të lehtë sesa mendohej punën e ARRSH dhe firmës ndërtuese të autostradës.

Ajo që po shohim këto ditë tek Unaza e Re është vetëm episodi i radhës i betejës së shtetit me ndërtimet e paligjshme. Është thënë shpesh se në gjithë Shqipërinë ka rreth 400 mijë të tilla dhe se ky fenomen përbën një pengesë serioze, në rrugën e zhvillimit të vendit, fuqizimit të ekonomisë, bujqësisë, turizmit dhe thithjes së investimeve të huaja. Për herë të parë, pas disa ndërhyrjeve kryesisht në bregdet dhe zona të caktuara informale, shteti po ndërmerr shembje masive në këmbët e kryeqytetit. Kjo që po ndodh nuk ngjan me shembjet në Shkozë apo ato të dhjetëra apo qindra kioskave, dyqaneve e shtesave të pallateve nëpër Tiranë. Unaza e re e kryeqytetit po fillon të hapë trasenë e saj mbi një mizëri ndërtimesh, të cilat padyshim llogariten në disa mijëra (rreth 3500 sipas disa shifrave), kur projekti të jetë përmbyllur.

Kjo që po shohim është pra, vetëm një pjesë e asaj që pritet të ndodhë në vitet në vijim. Beteja për 300 ndërtimet e para të shembura të Unazës së re, është në fakt përpjekja për të imponuar një model të caktuar, një raport të parë konkret mes shtetit dhe pronarëve të ndërtimeve pa leje. Jo se kjo nuk ka ndodhur aty-këtu më parë, jo se kuadri ligjor nuk ekziston prej vitesh, por, sepse impakti social, ndjeshmëria e kësaj sfide aktuale, masiviteti dhe afërsia e saj me Tiranën, e kanë kthyer këtë



projekt në "lakmuesin" e forcës së shtetit dhe të imponimit të ligjit, edhe në rrethana kur diçka e tillë krijon impakt social jo të vogël.

Nuk është aspak e këndshme

të nxjerrësh plaçkat, apo të mbyllësh biznesin këto ditë të ftohta dimri. Secili nga ata që kanë një shtëpi tek Unaza e Re, e cila këto orë po shembet nga fadromat, po kalon një dramë personale

therëse dhe të vështirë për veten dhe familjarët që ka pas. Dhimbja e atyre njerëzve, të cilët pas 20 vitesh të qeta banimi në ato shtëpi, i kujtojnë ato të ligjshme dhe detyrimisht të ko-

mpensueshme, është e vërtetë dhe jo e rreme.

Megjithatë shteti nuk ecën përherë sipas ndjesive dhe emocioneve të një pjese të shtetasve të tij. Liria ime përfundon aty fillon liria e të tjerëve, thotë shprehja e njohur. Tiranë, e bashkë me të e gjithë Shqipëria, s'mund të zhvillohen sipas logjikave dhe interesave momentale të politikës, e as sipas interesit të komuniteteve të caktuara. Ata që ndërtuan një dekadë më parë kuadrin ligjor për ndërtimet pa leje në Shqipëri, ishin njëkohësisht edhe ata që nuk i zbatuan kurrë ligjet që shkruan, e zëza në të bardhë. Dhe e bënë këtë sepse votat e Unazës së Re, e të gjitha zonave të tjera informale në vend, i panë si serbatorë votash për t'i përdorur në funksion të pushtetit të tyre. Kjo llogari me skine ka qenë një bonus i padrejtë që politika i ka bërë shkeljes së ligjit.

Ky është një model i prapambetur, hileqar dhe anti-zhvillim. Banorët e prekur nga projekte si ky i Unazës së Re duhet të kenë të gjithë empatinë e shtetit, por nuk duhet të kenë shtetin si pjesëmarrës në shkeljen e ligjit që ata kanë bërë, duke ndërtuar pa leje. Banesa sociale, kredi të buta e gjithfarë formash të tjera suportit duhen studiuar këtej e tutje, jo vetëm për Unazën e Re, por për shumë e shumë raste të ngjashme në të gjithë territorin. Sepse njollat e ndërtimeve abuzive janë prej shumë vitesh gangrena që pengon sa e sa projekte zhvillimi, sa e sa vende të reja pune, rrugë, vepra sociale, projekte industriale, turistike e bujqësore.

Me ndërtimet pa leje duhet një qasje afatgjatë dhe parimore. Është kjo njëra ndër ato sfida që shteti shqiptar e ka përballur në mënyra të improvizuara, të pabarabarta dhe për pasojë joligjore. Triumfi i ligjit tek Unaza e Re është shembulli i parë i fortë i fuqisë së shtetit, për të imponuar fuqinë e ligjit. Gjithçka tjetër është më pak e rëndësishme./ javanews

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinioni *i* Ditës

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

# Rama s'lufton për kufij, por për like në "Facebook"

... megjithëse me dekor modern, pati një brendi të denjë për shekullin e XIX. Pas kësaj shfaqjeje sa folklorike, po aq edhe të pështrirë, një pjesë e mirë e opinionistëve kosovarë i janë përveshur venç kryeministrit të Shqipërisë.

Disa e kritikojnë se nuk respektoi shtetin e Kosovës dhe flakmuri në tij. Disa të tjerë se si gjithmonë nuk e shmangu dot rolin e paternalistit duke folur edhe në emër të tyre. Ka që shkojnë edhe më përtej duke fantazuar për një plan të përbashkët me Vuçiqin, që prodhoi menjëherë trazirat në Mitrovicën e Veriut. Ndërsa më të politizuarit mendojnë se zgjedhjet të mbështesë Thaçin në idenë e marrë të shkëmbimit të territoreve.

Të lexuara fjalë për fjalë, thënë e Ramës mund të interpretohen në secilin nga këto mënyra. Por, të para në një perspektivë afatgjatë, të gjitha këto kritika janë lavdërime të pamerituara për një njeri, që nuk ka as plan, as projekt dhe as strategji të mirëmenaduar, por sillet thjeshtë si një adoleshente në kërkim të vëmendjes.

Të gjithë kolegëve të mi në Prishtinë, që i janë vërsulur Edi Ramës duke e marrë seriozisht dua t'i kujtoj një ndodhi që ka ngjarë pak kohë më parë në një mbledhje të kabinetit qeveritar.

E ka rrefyer në vetë të parë një njeri që ka qenë aty prezent. Një nga ata personazhe që kryeministri ynë, idhëtar i politikës spektakël, e gradoi zv ministër arsimit, vetëm se kishte arritur të krijonte pak bujë në shtyp.

Dhe ky zv/ministër, që e turpëroi shefin e vet, sepse dha dorëheqjen vetëm pas dy javëve në detyrë, tregoi një skenë marra mendëse nga mbledhja e qeverisë ku arriti të marrë pjesë. Një skenë kafkiane ku shefi i kërkonte llogaritë të rreptë vartësve ministra për pëlqimet që kishin marrë në rrjetet sociale. Ky ishte preokupimi madhor i atij tubimi. As sa detyra kishin realizuar, as dosjet qesharake që i dërgojnë Brukselit duke pretenduar se do të hapë negociatat, por vetëm e vetëm se sa atraktive kishin qenë për konsumuesit e "Twitter", "Instagram", "Facebook".

Ndoshta po t'i kishin kushtuar vëmendjen e duhur këtij rrëfimi edhe kolegët e mi në Prishtinë nuk do të kishin qenë aq serioz në kritikën për Edi Ramën.

Ndoshta po ta shikonim me këtë sy as do të ishin kaplur nga para-



noja për një projekt ogurzi të gatuar mes Tiranës dhe Beogradit dhe as për ndonjë shitje të territoreve që sot i përkasin Kosovës.

Përpara tyre do të kishin ngritur pyetje pak më të thjeshta:

Si shpjegohet për shembull që vetëm brenda katër ditësh ministri i Financave dhe kryeministri shfaqen me qëndrime krejt të ndryshme në publik për sa i përket taksës 100% që u vu për prodhimet serbe? Si shpjegohet që shefi i diplomacisë në Tiranë, ka një qasje ku e ku të pakrahueshme me atë të Edi Ramës për shkëmbimin e territoreve? Si ka mundësi të shpërfaqet me kaq lehtësi ky amatorizëm për të cilin

do të skuqeshin edhe qeveritë më qesharake të rruzullit? Si ka mundësi që në një ekip, ku nuk pipëtin askush veç të parit, të ketë të tillë zëra alternativë?

Përgjigjet për këto pyetje janë fare të thjeshta. Kjo kakofoni është shembulli më i ilustrues se qeveria e Tiranës, nuk ka as plan, as strategji dhe as projekt. Prandaj Arben Ahmetaj foli korrektësisht sipas traditës që ndjek Shqipëria prej vitesh dhe Edi Rama, në një sfond me flamuj dhe me shqiponja, në Pejë, improvizoi një qëndrim krejt të kundërt.

Kryeministri, ndryshe nga qëndrimi i akullit i vartësit të vet, e ndjeu se shou që organizoi në

tubimin e përbashkët të dy qeverive, i jepte më shumë "like" në Facebook. Dhe sipas modelit të asaj mbledhjes së kabinetit, që tashmë është bërë e njohur në Tiranë, ai veproni menjëherë. Thjesht për shfaqje. Për të rënë në sy mbi të tjerët. Për të tërhequr pak më shumë vëmendje.

Për këto arsye qëndrimi i kritikëve të tij në Prishtinë u duk pak i ekzagjeruar. Sepse Edi Rama nuk duhet marrë seriozisht për ndonjë plan afatgjatë. Ai as nuk mund të ndajë, as të bashkojë shqiptarët. Ai thjesht do të shtojë ndjekësit e tij në rrjetet sociale.

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Nervozizmi i tepruar mund të ndikojë në marrëdhëniet me të tjerët. Besojini këshillave të miqve dhe atyre që keni pranë. Bëni durim nëse po planifikoni për të investuar diku.

**DEMI**  
Nuk është momenti i duhur për të marrë përsipër gjëra që kërkojnë kohë e mund. Problemet financiare sot në mëngjes mund të bëjnë që të gjendeni në telashe.

**BINJAKET**  
Përpqini të ruani balancën sa i përket shpenzimeve. Aktualisht nuk është momenti i duhur për të bërë blerje të shtrenjta.

**GAFORJA**  
Ruani qetësinë në çdo gjë që bëni dhe merri në konsideratë këshillën e atyre që ju rrethojnë. Mund të ndiheni të nervozuar për shkak të disa problemeve financiare.

**LUANI**  
Po kaloni disa momente ankthi në lidhje me shëndetin tuaj. Janë çaste kalimtare. Sa i përket dashurisë ndiheni mjaft mirë me veten tuaj.

**VIRGJERESHA**  
Këshilla e miqve dhe atyre që ju rrethojnë mund të rezultojë shumë frytdhënëse. Sot do të merrni një lajm shumë të mirë e ndoshta edhe një vizitë të këndshme.

**PESHORJA**  
Mos rezikoni me lojërat e fatit, sepse yjet nuk ju favorizojnë. Evitoni debatet e kota me partnerin, sepse nuk do të mund të zgjidhni asgjë.

**AKREPI**  
Do të merrni një ofertë interesante pune që duhet ta analizoni me kujdes. Ndodhi të papritura do të bëjnë që të ndryshoni të gjitha planet që kishit bërë për sot.

**SHIGJETARI**  
Mund të mos jeni në humor shumë të mirë për shkak të problemeve shëndetësore, por nuk ka vend për t'u shqetësuar, pasi është periudhë që do të kalojë shumë shpejt. Dashuria ecën mjaft mirë.

**BRICJAPI**  
Shanset për të bërë para janë të shumta, por duhet të dini si t'i kapni këto mundësi. Mëngjesin e sotëm mund të jeni me humor të keq.

**UJORI**  
Ditë e mirë në sektorin e parave. Investimet favorizohen, ashtu siç favorizohen edhe aplikimet për punë. Në dashuri nuk keni shume fat.

**PESHQIT**  
Dilni nga kllapia dhe veproni menjëherë, nëse nuk doni që të ngelni mbrapa. Gjë që nuk është kushtet se çfarë, zakonisht. Për të gjetur çelësin e problemit, nevojitet që të keni qetësinë e duhur mendore dhe të mos shpejtoni.



**BLUE TOOTH**

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



te rejat nga jeta

**Vipave**

çdo të shtunë falas me

**PRESIDENTI I PARTIZANIT**

**P**residenti i Partizanit, Gazment Demi, ka folur para mediave në fund të derbit, duke deklaruar se ekipi i tij tregoi edhe një herë karakterin luftarak, ndaj fitoi në derbi. Demi konfirmoi se në janar mund të ketë ndërhyrje në merkato sipas kërkesave nga stafi i të kuqeve. "A u shqetësova pas golit? Pse të shqetësoheshim?! Edhe të fitonte Tirana, nuk do të ishte ndonjë çudi e madhe. Kemi qëlluar një herë që

**Demi: Partizani tregoi karakter**

kemi barazuar në minutën e fundit, sot e përmbysem, kish të kohë loja. Mendoj se Partizani e ka gjithmonë karakterin, edhe këtë ditë e tregoi karakterin e tij. Nuk mund të them që këtë herë ka më tepër karakter; janë grup serioz, po punojnë mirë, stërviten mirë, e keni parë që janë çuna të rinj që luajnë. Them se do të shkojë mbarë. A më kënaq eki-

pi? Po vjen aty ku do të më kënaqë, nuk më ka kënaqur akoma si dua. Sulmues në janar? Atë e di stafi teknik, thjesht u kam thënë që të kërkojnë atë që duhet dhe unë do mundohem të plotësoj çdo kërkesë të stafit. Premio? Nuk luftojmë për dhuratë, por ekipi lufton për të fituar. Gjithsesi, do të shohim", tha Demi.

**PRESIDENTI I TIRANËS**

**Halili: Do të ndërhyjmë në merkato**

**T**irana duket se ka dalë jashtë objektivave dhe këtë e ka pranuar edhe vetë Refik Halili, presidenti i Tiranës, i cili për mediat e pranishme në "Selman Stërmasi" foli për ndeshjen e humbur me Partizanin dhe tashmë e ka pranuar se bardheblutë kanë dalë nga objektivi për kupat e Europës. Por ai premtoi edhe ndryshime në skuadër. "Them që të paktën do të lëvizim nga kjo gjendje që jemi. Na vjen keq që nuk

kapim objektivat. Shpresojmë që pas muajit janar të bëjmë ndryshime sa u përket rezultateve. Klubi ynë ka lojtarë të mirë, por ka edhe shumë punë për t'u bërë ende pasi kampionati është i gjatë. I takon stafit ta bëjë ndryshimin. Ka disa lëvizje që mund të bëhen. Në të ardhmen mund të lëvizim në formacion. Goli i djalit? Është

kënaqësi që një futbollist i ri të shënojë. Shpresoj që në të ardhmen të aktivizojmë ndonjë lojtar nga akademja, pasi po dalim nga objektivat. Të paktën të fitojmë lojtarë për të ardhmen. Mema?! Do vazhdojë, për mua mund të vazhdojë gjithë jetën. Nuk kam asnjë problem për Memën, përfundon presidenti i bardhebluve, Refik Halili.

Gola, traversa, luftë sportive. Derbi nuk zhgënjen asnjë. Fitojnë të kuqtë, dëshpërohen bardheblutë



Jeton Selimi

**Partizani mbretëron në kryeqytet, përmbys Tiranën në derbin e madh**  
*Shënon i pari Halili, më pas vulos Hebaj me dy gola*

**P**artizani dhe derbi janë kthyer në një dashuri të pandashme. Të kuqtë thyjnë Tiranën në derbin numër 151 dhe vijnë marshimin në krye të renditjes. Në "Selman Stërmasi" ndodhi çdo gjë, gola, traversa, emocione dhe përmbysje. Në fund buzëqeshin ata, djemtë e Skënder Gegës, që sikundër edhe në derbin e parë të këtij sezoni, dalin fitimtarë. Tirana flirtoi me fitoren. Kryesoi me golin e Grent Halilit, që në minutën e 51-të dërgoi në ekstatë atë pjesë të tifozërisë bardheblu që nuk e kishte bojkotuar ekipin. Më pas Gega luan kartën "Hebaj" dhe çdo gjë ndryshoi. Eldorjan Hamiti vërshëllën fillimin e ndeshjes nën një atmosferë spektakolare të ultrasve të kuq, ndërsa Tirana është ajo që e nis më mirë. Por me kalimin e minutave, Partizani e rrit lojën. Dy momentet



lipikante në këtë fraksion loje. Penalltia e pretenduar nga Trashi në minutën e

31-të dhe traversa e goditur nga Asani në minutën e 45-të. Më pas të gjithë në

dhomat e zhveshjes. Prej andej Tirana del më e motivuar. Në minutën e 51-të

Ardian Mema fiton 'babin' e tij. Grent Halili shënon dhe vrapon ta ndajë gëzimin me babain e tij, presidentin e Tiranës. Partizani tronditet, por mendon Skënder Gega ta ndryshojë situatën. Hedh në lojë Rubin Hebajn, shkodranin që nuk ishte ngjitur në asnjë moment në pritshmëritë e tij. Një tjetër bast ky në këtë ndeshje. Dhe Hebaj shpërthen. Mensah krosin për kokën e shkodranit në minutën e 67-të, që rikthen baraspeshën. Tani tronditja kalon te Tirana, me Partizanin që hidhet në sulm për golin e fitores. Gol që do ta arr-

ijë në minutën e 86-të, menjëherë pas traversës së Hilës. Dhe është aksion shkodranësh. Çinari harkon tokazi në shtyllën e dytë, aty ku Hebaj flirtoi me fitoren e Hoxhallarit dhe ndëshkon Arbiban për herë të dytë. 2-1 për të kuqtë, shpërthejnë tifozët e Partizanit që shijojnë fitoren e radhës. Mërzhi dhe trishtim te Tirana, që prej 15 ndeshjesh dhe 5 vjetësh nuk gjejnë një fitore në derbi. Partizani kryeson kampionatin në kuotën e 34 pikëve, 4 më shumë sesa Skënderbeu që luan të shtunën, ndërsa Tirana mbetet me 11 pikë dhe e përsërit në luftën për mbijetesë.

**TRAJNERI I PARTIZANIT**

**A**rkitekti i këtij Partizani, Skënder Gega, është i lumtur pas ndeshjes. Fitorja ndaj Tiranës është një fitore prestigj në derbin e shumë dëshiruar, ndërsa timonieri i kryesuesve të kampionatit vlerëson tri pikët, por edhe kundërshtarin.

**Partizani reagon, pëson dhe reagon...**  
Rëndësi ka që morën 3 pikë. I uroj Memës karrierë të gjatë dhe e do fanellën e tij me shpirt. Besoj se patëm vështirësi, momenti që u ndëshkuam mund ta largonim topin. Jam i kënaqur për karakterin që treguam.

**Derbin e vendos një lojtar që vjen nga stoli...**  
Çdo trajner e fillon me 11 dhe i respektoj ata që

**Gega: Më gëzon fitorja, Memës i uroj karrierë të gjatë**



kanë veshur fanellën e Partizanit. Secili ka pasur perceptimin e vet për Hebajn. Shënimi i tij i golit na gëzoi të gjithëve.

**Çështja "Hoxha", çfarë ishte vendimi surprizë për ta hedhur në formacion?**  
Ajo që ndodhi me Albanin

nuk është e mirë për asnjë sportist. Të gjithë ne mund ta kemi tepruar ndonjëherë. Nuk mund të gjykoj, gjithësi ishim para një fakti. Si teknik thashë që do kisha dëshirë që ai të ishte 100%, mirëpo 2 ditët e fundit trajnerët më dhanë garanci që ishte në formë optimale, kështu që unë bëra zgjidhjen. Nuk ishte kapiten, nuk është zgjidhje e lehtë.

**Ishte presioni për ta fituar ndeshjen? Mensah ishte më mirë...**  
Mensah i ka dhënë shenjat në Vlorë që është mirë. Ai hyn në zona të ngushta, i kam dhënë unë direktivat të

lëviz edhe më shumë. Gjithsesi, asgjë nuk është absolute. Edhe ndërrimet mund të bëhen të gabuara ndonjëherë. Do të kisha dëshirë të shihja ndeshje me qetësi. Tirana ishte e mobilizuar. Nuk e meritojnë aty ku janë. Goditëm shtyllat dhe na u mohua një penalti.


**Ju si trajner keni hyrë në lojë mbas shënimit të golit të Tiranës, skuadra nuk mori përsipër...**  
Mendoj që ne vendosëm në fillim të prisnim në minutat e para Tiranën. Nëpërmjet hapësirave do të gjenim diçka. Në pushim vendosëm që të prisnim dhe mos të nxitoheshim. Mbrojtësit e qendrës dhe Mala na ndihmuan. Pa hyrë Hebaj ishte pak i veçuar.

**TRAJNERI I TIRANËS**

**Mema: Nuk mund të fshihemi pas gishtit, Doka gaboi**

**T**rajneri i Tiranës, Ardian Mema u pa shumë i tensionuar në fjalën e tij pas ndeshjes kundër Partizanit. Për mikrofonat e "Supersport", Mema bëri analizën e ndeshjes, ku kritikoi disa lojtarë me emra konkretë: "E njëjta tablo siç ka ndodhur në ndeshjet e kaluara. Të them të drejtën, nuk luajtëm më mirë se Partizani. E patëm mundësinë që ta menaxhonim rezultatit. Edhe për të shkuar drejt një fitoreje ose barazim maksimumi. Problemi ishte që të auti. Të pësoh golin nga auti është realisht problem. Nuk mund ta kuptoj se si mund të ndodhë. Konkretisht është Doka. Nuk e di se si mundet të vazhdojë në këto kushte. Ka pasur polemika brenda skuadrës, nuk kanë qenë të gatshëm ta kuptonin se Halili do të lozte, unë e shoh gjendjen në stërvitje. Kam bërë dy ndërrime të tjera, që janë gabimi im dhe këtë e marr përsipër unë. Ishte gjithë kohës Daja që e bllokonte, nuk mendoj se na ka ardhur e keqja nga Trashi apo dikush tjetër. Pa përgjegjëshmëria jonë i ka sjellë fitoren Partizanit, është duratë e radhës. Gjerat janë të dukshme dhe nuk mundet të vazhdojmë më duke u fshetur pas gishtit. Lojtarët i prek loja. Futboll është gjatë gjithë kohës prezencë. Gjatë gjithë kohës do kesh një performancë të mirë. Gabimet janë të dukshme dhe janë evidente. Goli i dytë ishte si rrjedhojë e mos përqendrimit të Hasanit. Pjesa tjetër pati ato probleme që është e kotë t'i komentoj.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Riza aktor.
- Një fjalë si hij.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtom të bëhet as.
- Janë felinë... të zinj.
- Ami i Maupassant.
- Heroi i Emilio Salgarit.
- Qe anarkist i famshëm rus
- Një mungesë gjaku.
- Susanna shkrimtare
- Të parat në cilësi.
- Mbyllin një shtëpi.
- Mbeten në fund.
- Qendër në kaos.
- Ka bërë piktoreskë një i tillë
- Inicialet e Camus.
- Motra... e Kolë Idromenos
- Një konfuzion total.
- Rastet pa set.
- Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (Indic).
- Triplet e Trëndafilit me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

**VERTIKAL**

- Fillojnë praktikën.
- Britma e Arkimedit.
- Ekstremer në trap.
- Në fund të fundit.
- Janë fjetoret e ushtarëve
- Parker regjisor.
- Vivaldi kompozitor.
- Një shkop për karambol.
- Janë firmat rentiere.
- Një i fundit mbi të gjithë
- Kufizojnë tatimet
- Janë nomadë.
- Panik pa kufij.
- Fryn detin
- Sidney regjisor i Serpico.
- Jep alarmin.
- Fillojnë gazet.
- Janë llogari.
- Alan regjisor.
- Roman regjisor.
- Eshhtë X ajo e sulmit.
- Kapen të parat.
- Një provë... inteligjence.
- Një markë lap top.
- Fillojnë matjet.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Qerre pa qe.
- Fillojnë lirinë.
- Fillojnë vallen.
- Në mes të dhomës.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Një doktor... i Fritz Lang
- U paraprind hoteleve.
- Kush nuk ka... nuk ha
- Eshhtë djall
- Një mund të ketë i rrallë.
- Ishin perëndi të Samotrakias.
- Institucione Botuese Autonome.
- Eshhtë infeksion në bark
- Fundi i një samurai.
- Një markë kafeje.
- Mbyllin një hark.
- Mund të jetë emërore.
- Ishte muzikanti që nuk përsërite.
- Në krye të avokatëve.
- Qerre pa qe.
- Një pjesë e adoleshentëve.
- Një banor imagjinar i planetit të kuq.
- Nuk shuhej dot nga Tantali.

**VERTIKAL**


- James, armiku i Sherlock Holmes.
- Eshhtë edhe ajo saudite.
- Imami aktore
- I kanë çift turket.
- Inicialet e Seagal aktor.
- Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
- Në fund të lutjes.
- Eshhtë sporti me stil të lirë.
- Mbeten në fund.
- Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argjentinasi.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshhtë qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëloj për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshhtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rrallë është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

8	5		4						3
9			7	3					2
2	7		8						6
		6		1		5			4
1	9								
	4			5	6	8	3		
4			1	8	3	7			
						2		9	
6	1			2					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

1	7	4	6	2	5	3	9	8
3	2	8	4	7	9	1	5	6
6	9	5	1	3	8	4	2	7
2	8	6	9	1	7	5	3	4
5	1	3	2	8	4	6	7	9
9	4	7	3	5	6	8	1	2
7	5	2	8	4	1	9	6	3
8	6	1	7	9	3	2	4	5
4	3	9	5	6	2	7	8	1

*Argëtim filozofik*

"Miqësia është kryesisht siguri, dhe kjo është ajo që e ndan atë nga dashuria. Gjithashtu do të thotë respekt dhe pranim absolut i tjetrit.

"Mundësia nuk troket derën vetëm një herë, troket vazhdimisht. Por në shpesh nuk e dëgjojmë trokitjen e saj, apo pretendojmë se nuk dëgjojmë ose kemi frikë t'i përgjigjemi.

"Nëse ndihesh i vetmur kur je vetëm, ke shoqëri të keqe".

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	
1		12	4	2	12	4	11		6	1	9		
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2		
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12	
3			5	10	3	1	14	4	6	1			
4	12	2		5	1	7	2	12		11	3	3	
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4	
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8	
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14	
7	2	14	4	12		7	K	1	9	S	H	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12	

K	A	F	E			T	A	L	E	N	T		
A	D	A	M			P	A	F		T	E	R	
T	E	T		H	E	P	A	T	I	T	I		
E	T		H	E	R	E	T	I	K	E			
G		K	O	M	I	T	E	T	E	T			
O		E	K	I	P	E	T		T	A	F		
R	I	K		N	E	T		T	A	P	A		
I		O		G	C		S	T	I	L			
K	P		S	W	I	N	G			S	L		
E	O		P	A	T	E	N	T	A	T			
	N	A		Y	E				U	R	A	T	
T	Y	M	I			P	I	R	A	T	I		

*Thënie të mençura*

- "Eshhtë shumë e vështirë për të kujtuar pikëpamjet e mia pa kujtuar arsyet pse i kam këto pikëpamjet!"
- "Aksidentet e makinave ndodhin për shkak se shoferët e sotëm ngasin në rrugët e djeshme, me makinat e së nesërme dhe me shpejtësinë e së pasnesërme.

- "Njerëzit gjithmonë do të vënë re ndryshimin e sjelljes tënde përballë tyre.
- Por kurrë nuk do të pranojnë se sjellja e tyre ishte shkak i ndryshimit tënd.
- "Ju keni mënyrën tuaj. Unë kam mënyrën time.
- Tani, sa i përket mënyrës së drejtë, mënyra korrekte, mënyra e vetme, nuk ekziston."

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR**

C	L	A	U	D	E	K	N	I	M	G	O	L
S	A	G	A	N		G	A	N	I	M	E	D
O		K	A	M	I	K	A	Z	E			
L	A	R		P	A	G	A	N	I	N	T	A
O	K	A		K	L	A	S	T		O	M	A
K	E	F	A		K	U	V		L	I	K	A
A	R	O		S	A	K	T	E		E	T	M
L	O	B		T	N	R		A	T	E	A	
L	N	I		C	O	T		A	H	E	R	O
S	T	A		U	I		A	P		O	N	K
P	I		S	T		A	M	O	S	T	I	E
Y	A	R		D	E	M	E	T	R	A		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

